

■ Faqe 7
Licensimi, qeveria nis garën për lotarinë kombëtare

■ Faqe 8
Kodi Krugor, drejtori i Policisë: ja si do ndëshkohen shkelësit

■ Faqe 9
Berisha kthen kooperativat Themie Thomai: 20 vjet abuzime

■ Faqe 10
Matura 2012, nxënësve u kërkohen libra që s'i kanë patur në shkollë

■ Faqe 11
Kthehet në shkollë, do të mbyllet konvikti i gjuhëve të Huaja

■ Faqe 12
Investigimi, Teatri Kombëtar pa ngrohje, 150 litra naftë në natë

[SHQIPTARJA.com]



LEKË 20

VITI II - NR. 7 E enjte, 12-01-2012

Operacioni "Pronë e spostuar", në pranga ish-drejtori dhe punonjës të AKKP-së

6 ZYRTARET HAJDUTE

Ja si e falsifikuan pronën në Kavajë Bënë tokë buke rërën e detit në Spille

Lajmi

Konfliktet e shumta brenda fisit Jenisleri kanë sjellë që disa prej tyre të "spiuojnë" lidhur me 79 dym tokë të marrë në mënyrë abuzive nga shteti. Pas 6 muajsh hetime, policia vuri në pranga 5 zyrtarë dhe shpallim në kërkim 1 bashkëpunëtor të Kthimit dhe Kompesimit të Pronave në Tiranë, të akuzuar për shpërdorim detyre.

TIRANE

ADELA SHEHU

Dënoncimet e shumta të qytetarëve, kryesisht të pronarëve pretendentë të tokës në zonën e Spillesë kanë bërë ngritjen e një grupi hetimor për të kryer verifikimet përkatëse të ish-zyrtarëve të AKKP. Policia arrestoi dje gjashtë ish-zyrtarë të lartë të Agjencisë së Kthimit dhe të Kompesimit të Pronave, pasi akuzohen se kanë shpërdoruar detyrën duke kthyer disa prona në Spille personave që nuk ishin pronarë të vërtetë të saj. Bëhet fjalë për një truall prej 79 dym tokë në vijën bregdetare të Vilë-

Braçe kundër

Faqe 6



Zgjedhja e presidentit, përplasje në kryesinë e PS për "konkursin"

NGA JAKIN MARENA

Basthovës, Grethit, Spillesë dhe Domenit. Këto zona u bënë pronë e Jenisherëve. Kjo familje njihet si "pronare e dokumenteve të tokës", sipas ish-zyrtarëve të kthimit të kompesimit të pronave, të cilët abuzuan duke i dhënë sipërfaqen

tokës. Persona të ...brendshëm të fisit Jenisleri thanë se kanë pasur probleme familjare dhe disa prej tyre kanë spiunuar se sipërfaqja e tokës ishte e marrë në mënyrë të padrejtë. Prangosja e ish-zyrtarëve...
vijon në faqen 2

Editorial

NGA EDLIRA MUEDINI

Dilemat para një interviste

Sot do të dëshiroja të ndaja me ju një tjetër aspekt, pjesë përbërëse e punës tonë të përditshme në ofrimin e shërbimeve të personelit. Pas marrjes së aplikimeve për vendet e punës që kompania jonë ka shpallur për kompanitë kliente dhe pasi kryejmë përzgjedhjen e parë të aplikantëve bazuar në eksperiencat që ata kanë paraqitur në CV-të e tyre, ne përgatitemi për procesin e intervistimit të kandidatëve të përzgjedhur. Por ndodh në disa raste që një aplikant, i cili ka aplikuar dhe është përzgjedhur nga dokumentacioni i paraqitur për një intervistë, tërhiqet nga aplikimi në momentin kur ftohet për këtë intervistë pune. I njëjti fenomen ndodh edhe kur kandidati ka kaluar fazën e parë të intervistimit dhe ftohet për të kryer intervistën me punëdhënësin e ardhshëm, ai nuk paraqitet në këtë intervistë.

Cilat janë shkaqet e këtij fenomeni? Po përjashtoj fillimisht rastin kur aplikanti ka gjetur një punë ndërkohë dhe nuk është më i inëterësuar dhe po ndalem në analizën e rastit kur aplikanti është i papunë, aplikon për një pozicion pune, kryen edhe një intervistë të parë me sukses dhe në momentin final kur ai apo ajo do të përballlet me punëdhënësin e ardhshëm tërhiqet.

Tërheqja nga aplikimi justifikohet dhe është për tu vlerësuar në rastin kur vjen si shkak i ndërgjegjësimit më të mirë të aplikantit

vijon në faqen 4

INTERVISTA

Kreu i shtetit në "Fiks Fare": Jam mbi palët. Berisha: Topi nuk na pyeti

Topi: I lumtur që nuk iu binda PD-së

TIRANE



Patatina Nachos dhe Meksikane
shoqëruar me salcat dhe djathin përkatës
Adresë: Autostada Tiranë - Durrës, kati 7, Yrshok Tiranë. Tel: 022 480 580;
042 486 501; Fax: 042 486 502; e-mail: neranxi@neranxi.com; www.neranxi.com

Presidenti i Topi ka sqaruar pozicionin e tij në lidhje me zgjedhjen e pasardhësit, duke u shprehur se nuk do të kërkojë interpretim në Kushtetues për kuorumin. Ai tha se ndjehej mirë që s'kishte zbatuar vendimet e PD, duke zbatuar Kushtetutën, ndërkohë që foli dhe për të famshmen votë në zgjedhjet e 8 majit...
vijon në faqen 4



Vonesat në kthimin e pronave, mundësi abuzimesh

31 dhjetori i vitit të kaluar ishte afati i kohor, pas të cilit të gjitha dosjet, që kanë dorëzuar ish-pronarët pranë AKKP-së, mbetën sërish pa një zgjidhje ligjore. Më 29 korrik të vitit 2004, mazhoranca socialiste e kohës kishte miratuar ligjin për këtë çështje, sipas të cilit procesi për njohjen duhej të përfundonte më 31 dhjetor 2006. Pesë muaj para këtij afati, qeveria

Berisha ndryshoi afatin, duke e shtyrë deri më 30 qershor të vitit 2008. Pas kësaj, vjen amendimi tjetër: më 10 prill të vitit 2008, mazhoranca aktuale vendos shtyrjen e re, deri më 30 qershor të vitit 2009, çka duket qesharake, duke patur parasysh se çfarë ishte bërë deri atëherë dhe sa mund të bëhej vetëm brenda 12 muajve pasardhës. Ky afat u shkëlqoi dhe më 22

korrik të 2010-ës u vendos që 31 dhjetori 2011 të ishte afati i fundit. Është folur për 8 mijë dosje, që "fleenë" në zyrat e AKKP-së, por zyrtarë të Agjencisë kanë thënë se gjatë kësaj kohe janë shtuar edhe 1 mijë të tjera. Vonesat kanë të bëjnë me pamundësinë e qeverisë për kompensimin në të holla, por mungesa e kthimit fizik fshih tendenca për vjedhje të pronave.

Tokat në Spille, arrestohen 6 zyrtarët e pronave

Tokat në bregdet, fisi Jenisheri spiunoi abuzimet

Telefonatat në polici nisën aksionin për arrestime

ADELA SHEHU

vijon nga faqja 1

...është bërë mbi bazë të vendimit të gjykatës, e cila ka dënuar në mungesë duke i dhënë masën arrest me burg.

OPERACIONI

Ditën e djeshme në orët e pasdites Drejtoria Kundër Krimin Financiar në Departamentin Kundër Krimin të Organizuar dhe Krimeve të Rënda në Policinë e Shtetit, pas një hetimi pesë mujor, në bashkëpunim me Njësinë e Përbashkët Hetimore, Task-Forcë, Tiranë dhe Drejtorinë e Forcës së Posaçme Operacionale, u finalizua Operacioni Policor "Pronë e Spostuar", në kuadër të të cilit u bë i mundur arrestimi në fa-



Në foto: Plazhi i Spilles

Akuza

Ish zyrtarët akuzohen për veprën penale të "shpërdorimit të detyrës dhe falsifikimit të dokumenteve nga personi që e ka për detyrë" kryer në bashkëpunim. Ata kanë kthyer trashëgimtarëve të familjes "Jenisheri" një pronë prej 79 dynym, duke e spostuar pronën e kthyer nga vendndodhja reale në bregdetin e Komunës Gos Kavajë, si dhe duke ndryshuar dhe zërin kadastral nga tokë ranishte në arë.

U hetuan dokumentet mbi pronësinë e vjetër para vitit 1939, pra Vërtetimi Nr.70, protokolluar datë 01.06.2007 të Këshillit të Qarkut Tiranë. Sipas këtij vërtetimi, rezultojnë se pronat e vjetër është tokë buke dhe jo rërë deti, siç i është kthyer familjes Jenisheri. Zhvendosja e pronës gjatë procesit të kthimit. Referuar dokumentit të pronësisë së vjetër, lëshuar nga zyra e Regjistrimit të Paturisë Kavajë, rezultojnë se pronat e pretenduar është me vendndodhje në fshatin Rreth-Greth, të komunës Kryeviidh, dhe jo në fshatin Vilë-Bashtovë.

"Kufizimet e pronës së vjetër, referuar dokumenteve që janë paraqitur, nuk përputhen me pronën e kthyer nga Komisioni, sipas plan-rilevimit. Ndërsa harta me të cilën është pasqyruar pronat e kthyer është ajo e vitit para 1991, e jo sipas hartës së Zyrës së Regjistrimit të Paturisë.

Vendimi numër 276, datë 10.09.2008 i Komisionit të Kthimit të Pronave për familjen Janisheri, referuar plan-vendosjes së saj, për pjesën që është kthyer, ndodhet e gjitha në brezin ranor, aq më tepër deri në ujën e detit".

POLICIA

Inspektorët të Krimin Ekonomik kanë sekuestruar në cilësinë e provës materiale, të gjitha dokumentet që janë përpiluar pikërisht nga ish zyrtarët e AKKP.

Policia tha se janë vënë re shkelje lidhur me lëshimin e pronësisë së 79 dynym tokë duke i'a lëshuar si pronar familjes Jenisheri.

Policia tha se janë vënë re shkelje lidhur me lëshimin e pronësisë së 79 dynym tokë duke i'a lëshuar si pronar familjes Jenisheri.

grancë i shtetasve:

Ali Aliaj ish-përgjegjës i sektorit juridik i Agjencisë Kthim Kompensim Pronave në Tiranë, Bledar Dervishaj ish-drejtor rajonal i Agjencisë Kthim Kompensim Pronave Tiranë, Merita Gjinali ish-topografe e Agjencisë kthim Kompensim pronave, Dhimitër Papa ish-topograf i Agjencisë kthim Kompensim pronave në Tiranë, Altin Ceni, ish-jurist i Agjencisë kthim Kompensim pronave (në kërkim), si dhe është arrestuar Nijazi Ademi topograf privat i licencuar, ekspert. Operacioni për kapjen e tyre u bë në orën 15:00 të ditës së djeshme.

Askush nuk priste që pas lënies së detyrës, të fillonin hetimet aq më tepër të arrestohen të pestë ish-zyrtarët, të cilët para se të largoheshin lanë disa prej doku-

mentacioneve të parregullt. Shkelja sipas grupit të kontrollit është vënë re në disa prej dokumenteve që ishin përpiluar nga ish-zyrtarët lidhur me pronat në zonën e Spillesë. Sipas dokumenteve ishin tjetërsuar 79 dynym tokë, që i kaluan në mënyrë abuzive familjes Jenisheri.

Policia tha se është marrë dhe masa e sekues-

tros për këtë pronë, për të cilën pas regjistrimit të paligjshëm të saj, në Zyrën Vendore të Regjistrimit të Paturisë të Paluajtshme Kavajë, janë kryer dhe transaksione shit-blejeje midis personave të implikuar, me çmime shumë herë më të ulëta se vlera reale e tregut të tokës në këtë zonë.

HETIMET

Pikat kryesore se ku u

përqendruan hetimet e Prokurorisë ishin tek lloji tokës së kthyer, zhvendosjen e saj në pronë publike, largësinë sipas ligjit me vijën bregdetare (duhet 300 metra larg), verifikimit nëse ka apo jo mbivendosje, si dhe çdo dokument tjetër që ka argumentuar vendimin për kthimin e pronave familjes Jenisheri.



Në foto: Plazhi i Spilles (djathtas) Faksimile e shkresë së kreut të AKKP-së Çefa drejtuar komunës Kryeviidh për pronën Jenisheri

KRYETARI AKKP

Elvis Cefa: "Komuna e dinte"

Në një intervistë të dhënë pak kohë më parë, kreu aktual i AKKP-së, Elvis Cefa shprehej se vendimi për familjen Jenisheri është dhënë në vitin 2008 nga ish-Zyra Rajonale Tiranë e AKKP dhe është nënshkruar nga drejtori në detyrë në atë kohë, z. Bledar Dervishaj, në datën 10.9.2008 (vendimi nr.276) dhe vendimi i dhënë nga një zyrë rajonale prezumohet i ligjshëm për AKKP-në "qendër". I pyetur se çfarë do të bëjë AKKP-ja kur kryekomunari i Gosës dhe dy kryetarë të mandatuar në komunën Kryeviidh e kanë kundërshtuar vendimin e AKKP-së, Cefa shprehej se ankimi ishte bërë shumë vonë, vetëm në korrik 2011 3 vite nga marrja e vendimit. "Komuna Kryeviidh kishte dijeni për vendimin referuar shkresës së saj drejtuar AKKP-së në korrik 2011, pra kishte të gjitha mundësitë të kërkonte drejtpërdrejt një kopje të tij, pa pasur nevojë të referonte në numra paturish. Komuna ka pasur dhe ka edhe sot të gjithë mekanizmat ligjorë për të goditur me gjykatë çfarëdo vendimi apo akti administrativ, me anë të të cilit mendon se i janë cenuar interesat e saj"-shprehej Cefa.



**Komuna Kryevidh
shkresë AKKP-së
dy vite më parë**



Kryetari i komunës Kryevidh Fatos Kaja kishte deklaruar dy vite më parë se i kishte dërguar zyrtarisht dy herë një shkresë AKKP-së, që "të na dërgojë informacion mbi pronat e regjistruara, kopje të hartave treguese, si kopje të dokumentacioneve të tjera, me anë të secilës i ka kthyer tokat pranë

bregdetit Spille, Greth dhe Domen familjes Janisheri, por nuk kemi arritur që t'i marrim". Sipas tij, AKKP-ja rekomandonte që për zgjidhjen e çështjes komuna t'u drejtohet organeve gjyqësore. Tokave në Vilë-Bashtovës, Grethit, Spillesë dhe Domenit i ishin shtuar edhe 4 pretendentë, ku secili prej tyre theksoi se është pronar i një

gjese. Numri i tyre shkon deri në 8, por këta katër persona janë marrë parasysh, duke qenë se kanë pasur një dokumentacion për t'u marrë në konsideratë. Ndërkaq, sipërfaqja që i është njohur familjes Janisheri është shumë herë më e madhe sesa ajo e kthyer. Bëhet fjalë për qindra dynmë të tjerë, për të cilat kjo dinasti pret kompensim financiar.

Skandali i tjetërsimit u denoncua në 2010

Pronat, AKKP bëri rërën e detit tokë buke Kompesimi deri në buzë të detit Adriatik

TIRANE

ADELA SHEHU



Skandali që çoi dje në arrestimin e zyrtarëve të Pronave kishte arritur që të kthente rërën e detit në tokë buke, duke tjetërsuar pronën në fshatin Gosë të Kavajës, ku familjes Janisheri iu dha tokë publike pranë bregdetit të Spillesë, në vend të parcelave bujqësore ekzistuese që kishin pasur në pronësi, në një fshat tjetër. Përveç përplasjes Brenda fisit, denoncime kishin bërë edhe katër funksionarë të kësaj komune, të cilët njoftuan organet shtetërore për zhvendosje të tokës gjatë procesit të kthimit dhe njëkohësisht për vetësim të pronës publike, veprim të jashtëligjshme.

Sipas të dhënave, në 24 nëntor 2010, me rrugë zyrtare kryetari i Këshillit të Komunës, Agron Dema,

Sipas komunës ishte shkelur edhe ligji që thotë se deri në 300 metra larg vijës bregdetare, e gjithë sipërfaqja e tokës ka qenë tokë e shtetit.

kryeplaku i fshatit Vilë-Ballaj, Idriz Thaçi, sekretari i Këshillit të Komunës, Qerem Deliu, dhe agronomi i komunës, Myzafer Xhelili, vunë në dijeni për këtë zhvendosje kabinetin e Kryeministrit dhe ministrin të Drejtësisë, Nishani.

Shkresa i shkoi edhe AKKP-së Tiranë, Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë dhe Avokatuturës së Shtetit. Sipas shkresës, zyra e Regjistrimit të Pasurisë Kavajë, me vendim numër 276, datë 10.09.2008 të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave Tiranë,

iu kthye familjes Janisheri, një sipërfaqe toke prej 47 dynmësh, në fshatin Vilë-Bashtovë, me vendndodhje në brezin ranor deri në kufi me ujën.

Në ligjin 9235, dt. 29.07.2004, në nenin 7 të tij, thuhet se pronarëve nuk u kthehet toka publike, aq më tepër që ky subjekt nuk ka pronë të regjistruar në fshatin Vilë-Ballaj".

Sipas komunës Gosë, ligji ishte shkelur disa herë. Sipas dokumenteve të pronë-

sisë së vjetër para vitit 1946, prona e vjetër ishte tokë buke dhe jo rërë deti.

Sipas dokumentit të pronësisë së vjetër, lëshuar nga vetë Zyra e Regjistrimit të Pasurisë Kavajë, prona kishte vendndodhje në fshatin Rreth-Greth, të komunës Kryevidh dhe jo në fshatin Vilë-Bashtovë. Kufijtë e pronës së vjetër, sipas dokumenteve, nuk përputheshin me pronën e kthyer nga Komisioni, ndërsa harta me të cilën është pasqyruar prona e kthy-

er, është ajo e vitit para 1991, e jo sipas hartës së Zyrës së Regjistrimit të Pasurisë.

Vendimi numër 276, datë 10.09.2008 i Komisionit të Kthimit të Pronave për familjen Janisheri, referuar planvendosjes së saj, për pjesën që është kthyer, ndodhet e gjitha në brezin ranor, aq më tepër deri në ujën e detit. Sipas komunës ishte shkelur edhe ligji që thotë se deri në 300 metra larg vijës bregdetare, e gjithë sipërfaqja e tokës ka qenë tokë e shtetit.



Arrestimet në 2009

Aliaj, implikime edhe te Plazhi i "Gjeneralit"

Skandali tokat në bregdet shuk është i pari, as i fundit. Dhe as i vetmi për Ali Aliaj, zyrtarin e Zyrës së Kthimit dhe të Kompensimit të Pronave. Tre vite më parë ai ishte një ndër zyrtarët e AKKP-së, të akuzuar për tjetërsimin e 48 hektarëve pronë në vendin e quajtur "Gjiri i "Gjeneralit" në Kavajë. Sipas policisë, kjo çështje, kishte lidhje me kërkesën e kthimit të pronës së hartuar në emër të ish-pronarëve Nexhmi e Jonuz Shijaku, sipas dokumenteve të vjetra të pronësisë dhe plan-vendosjes së sipërfaqes së tokës. E gjithë përmbajtja e dosjes ka qenë e falsifikuar, ndërsa mbi këtë dokumentacion, AKKP-ja miratoi procedurën dhe vendosi kthimin e pronës, Hipoteka e ka regjistruar atë, ndërsa topografet kanë bërë verifikim të rremë në terren, duke zhvendosur tokën në dokumente, nga Mali i Robit të Gjiri i "Gjeneralit". Ndërkaq, akuzat kërkojnë masën "detyrim paraqitjeje" ndaj ish-kreut të Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, Tunxh Vatnika. Pas hetimeve, prokuroria kërkojë në gjykatë masën "arrest shtëpie" për katër persona: avokatit Gjergji Hyso, 53 vjeç. Ali Aliaj, 48 vjeç, punonjës i Zyrës Vendore të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, Petrit Kullolli, 53 vjeç, punonjës i Zyrës Rajonale të Kthimit



dhe Kompensimit të Pronave në Tiranë dhe Fatos Xhevdet Gjuzi, 45 vjeç, shefi i Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme në Kavajë. Sipas policisë, këta persona akuzoheshin për veprimet penale të shpërdorimit të detyrës, të kryer në bashkëpunim, falsifikim të dokumenteve nga personat që kanë për detyrë lëshimin e tyre dhe të mashtrimit. Por që të gjithë të akuzuarit më pas dolën të pafajshëm. Prona e pretenduar ishte dy kilometra larg bregut të detit, por ajo është mbivendosur në pronën shtetërore në Gjirin e Gjeneralit. Gjatë paraqitjes së tyre në Prokurori, asnjë prej të akuzuarve nuk e ka pranuar fajësinë e tij duke pretenduar se nuk janë të përfshirë në këtë skandal. Htetuesit e çështjes shprehën bindjen se veprimet e tyre ishin të parregullta dhe dëmi llogaritej rreth 24 milionë euro.

Abuzimi me pronat

Avokati i familjes Janisheri, organizator

Personi që aktualisht është në kërkim nga policia, si i implikuar në operacionin "Pronë e spostuar" është avokati i familjes Janisheri dhe burime të rezervuara nga Policia e Shtetit thanë për agjencinë NOA.al se nuk mund të deklarohet identitetin e tij për çështje të maftjes së sekretit hetimor. Por tanimë është prerë një urdhërarrest për të, i cili u është shpërndarë të gjithë njësive policore në të katra anët e vendit. Dyshohet se ky person, është larguar nga banesa gjatë ditëve të fundit. Nga provat që disponon deri më tani organi hetimor, dyshohet se avokati është strumbullari i të gjithë këtyre mashtrimit, që ka përfshirë këta persona. Fillimisht, organet hetimore morën në pyetje motrat Janisheri, njëra me banim në Durrës dhe tjetra në Lushnje, të cilat ishin trashëg-



imtare të këtyre pronave. Ato pohan gjatë seanceve pyetësore se ishte avokati i tyre ai që ishte marrë gjërë e gjatë me këtë çështje. "Ne i kishim dhënë atij një prokuror, ku e autorizonim të merrej me të gjitha veprimet lidhur me pronat tona. Ai na tha se kishin ndrequr gjithçka dhe se prona jonë ishte e rregullt", mësohet të ketë dëshmuar njëra nga motrat para prokurorëve. Duke qenë se ai i kishte kërkuar atyre vetëm paratë për çështjen në ngarkim, ato deklaruan se nuk kishin dijeni për allshverishet që ai mund të kishte bërë. Për momentin trashëgimtaret janë të lira, pasi nuk ka prova që t'i implikojnë. Arrestimi i avokatit në kërkim si dhe deklarimet e të arrestuarve do të zbardhin pozicionin e tyre, thanë burimet e policisë.



Vrasjet e 21 janarit, Bamir Topi: "Moment i dhembshur"

Presidenti Topi, i ftuar në emisionin "Fiks Fare" ka komentuar edhe 21 janarin 2011, ku 4 shtetas u vranë në boulevard. "Unë dëshiroj që këtë ngjarje ta trajtoj me seriozitetin e duhur. Ka qenë një ngjarje e hidhur, një ngjarje që askush nuk do të dëshiron ta përjetonte, sepse brenda një dite ne kemi parë dy pamje. Njëra anë dhunim i

institucioneve, tjetra të vrarë dhe të plagosur. Por, besoj kjo është një çështje e cila tashmë i takon institucioneve të drejtësisë që unë uroj ta trajtojnë me profesionalizëm dhe të japin drejtësi"-u shpreh ai. I pyetur për vrasjen e njerëzve nga garda, kur dhunim institucioneve ndodhin edhe në vende të tjera, si në Itali, e në Francë, ku

studentët hynë deri në parlamentin e Romës, presidenti u shpreh: "Ky është moment shumë i dhembshur, shumë dramatik, por për delikatesën e kësaj çështjeje unë besoj që janë po aktorët e shtetit që janë drejtuesit e institucioneve të drejtësisë që me profesionalizëm do të shprehin në momentin e duhur".

Kreu i Shtetit, në emisionin "Fiks Fare": Jam mbi palët

Presidenti, Topi: I lumtur që nuk iu binda PD-së

"I dhashë besim qeverisë Berisha kur e dekretova"

Lajmi

Presidenti i Topi ka sqaruar pozicionin e tij në lidhje me zgjedhjen e pasardhësit, duke u shprehur se nuk do të kërkojë interpretim në Kushtetuese për kuorumin. Ai tha se ndjehej mirë që s'kishte zbatuar vendimet e PD, duke zbatuar Kushtetutën, ndërkohë që foli dhe për të famshmen votë në zgjedhjet e 8 majit.

TIRANE

Kreu i shtetit, i ftuar në emisionin "Fiks fare" në Top Channel, foli për ngjarjet kryesore politike të vendit, nga 21 janari, deri të kandidatura e tij si president i vendit.

Më poshtë është shkurtimisht biseda e tij në emisionin "Fiks Fare".

Saimiri - Z. President kalojmë tek kjo pjesa e jonë që të jesh ndoshta më komod. Z. Berisha dhe Znj. Topalli e kanë deklaruar publikisht votën e tyre kundër presidentit në qoftë se do të kandidoni përsëri. Në qoftë se ju do të ishit në pozitën që do të votonit ose z. Berisha ose Znj. Topalli për president, do ta votonit?

Presidenti - Eksperiencia ka treguar që vota e presidentit nuk është e fshehtë. Pavarësisht çfarë shpreh unë, janë të tjerët që shprehin në emrin tim. E rëndësishme është që njerëzit kanë kurajo që të shprehin me transparencë.

Saimiri - Transparenca e juaj është po!

Presidenti - Edhe atje ku vota juaj është e fshehur, ju siguroj që transparencën e bëjnë të tjerët. Sigurisht duke e modifikuar.

Saimiri - Dmth do të votoj për të votuar, por kur të hapet kutia do të shohim për kë ke votuar.

Doktori - Tek votimi, desha ta pyesja kush do ta numërojë votën tuaj edhe në rast se votoni.

Presidenti - Mos kini merak, sepse ka njerëz të specializuar për të numëruar votën timë.

Saimiri - Është momenti që do zgjidhet presidenti, në fund të mandatit tuaj. Siç e keni theksuar do të jeni deri në momentin e fundit president dhe do t'ju uroja vërtet të jeni i tillë. Dhe do të jeni jam i sigurt. Megjithatë ka



Topi

Unë jam i bindur që jam president dhe i shumë demokratëve që militojnë në Partinë Demokratike, sepse fryma e ligjeve dhe e sjelljes patjetër është edhe fryma që përcjellin demokratët

një problem mes juristësh, konfliktet 71, 81, shumica, e ku e di unë çfarë tjetër! Është vendi ose momenti që ju t'i kërkon Gjykatës Kushtetuese të bëjë një interpretim të ligjit! Apo ngaqë nuk do jeni më president të bëjnë çfarë...

Presidenti - Sipas ligjit, sipas kushtetutës, natyrisht që ka presidenti të drejtë që t'i drejtohet Gjykatës Kushtetuese. Por këtë të drejtë e kanë edhe palët politike. Meqenëse ky debat ka lindur tek palët politike ato kanë edhe mundësinë që t'i drejtohen gjykatës kushtetuese. Për të qenë i drejtpërdrejt me ju, unë nuk do ta shfrytëzoj si president këtë atribut të presidentit për sa kohë e kanë të tjerët.

Saimiri - Jo, duke qenë se presidenti është mbi palët politike, dhe duke parë nga palët politike, siç keni parë dhe ju dhe kam ndjekur këtë pjesë?
Presidenti - Jepet sinkron kronika ku flet Berisha: "Z.Topi gjatë presidencës së tij ka ndërmarrë një seri aktesh do të thosha të pa pajtueshme kryeqytet me programin e Partisë Demokratike. Ka shkelur disa nga parimet e mëdha programore të saj."
Doktori - Më falni z. President por deri këtu keni arritur?

Presidenti - Unë e kisha dëgjuar, por e parë këstu sinkron ndihem vërtet i lumtur që marrë këtë konsideratë sepse ditën kur kam shkruar për tu betuar në parlament, për të qenë president i të gjithë shqipi-

gjykatës është i lirë që ta bëjë.

Doktori - Koleg i dashur je drejtuar gabim me pyetjen. Që të binim rehat z.President mos do të ishte më mirë që të ishte presidenca nën varësi të kryeministrit? Binim rehat edhe ju, edhe ne, edhe populli edhe të gjithë rehat.

Presidenti - Deri tani nuk parashikohet, por po të ketë ndonjë risi të marrveshjes së 21 Prillit për ndryshimet kushtetuese ndoshta edhe bën vaki.

Saimiri - Z. President meqë jemi tek udhëheqësi, deklaroi publikisht që z. Bamir Topi për ju, në presidencë, si president i republikës nuk ka zbatuar statutin e PD-së.

Doktori - Urdhër? Deri këtu ka arritur? Deri këtu?

Presidenti - A mund ta kemi në sinkron sepse unë nuk e kam ndjekur këtë pjesë?

(Jepet sinkron kronika ku flet Berisha: "Z.Topi gjatë presidencës së tij ka ndërmarrë një seri aktesh do të thosha të pa pajtueshme kryeqytet me programin e Partisë Demokratike. Ka shkelur disa nga parimet e mëdha programore të saj."
Doktori - Më falni z. President por deri këtu keni arritur?

Presidenti - Unë e kisha dëgjuar, por e parë këstu sinkron ndihem vërtet i lumtur që marrë këtë konsideratë sepse ditën kur kam shkruar për tu betuar në parlament, për të qenë president i të gjithë shqipi-

tarëve, për të respektuar kushtetutën, kam bërë dorëheqjen nga të gjitha funksionet e mija partiake. Fakti që unë kam shkruar atje më jep kënaqësi që të interpretohet në këtë mënyrë.

Doktori - Por jo të shkëlmi statutin e PD-së?

Saimiri - PD ju bëri president, apo ishit konsensus? Nejs! Me llogjikën e udhëheqësit tonë duhet, mund të ishit dhe presidenti, duke respektuar programin e PD-së?

Presidenti - Unë jam i bindur që jam president dhe i shumë demokratëve që militojnë në Partinë Demokratike, sepse fryma e ligjeve dhe e sjelljes patjetër është edhe fryma që përcjellin demokratët. Por nga ana tjetër qoftë në atë që thotë kushtetuta, por edhe në sjelljen time, presidenti është jashtë partive, por edhe duhet të jetë presidenti i të gjithëve. Qoftë i atyre që merren me politikë, atyre që nuk merren me politikë, atyre që kanë fobi nga politika, ato që kanë alergji nga politika. Unë jam president i të gjithëve. Kjo është parë në të gjithë ambientet. Qoftë në ambientet zyrtare, qoftë edhe në ambiente të tjera. Në stadium. Në ambiente të institucioneve kulturore. Në rrugë. Jam njësoj si më parë. Në gjithë marrëdhëniet me njerëzit.

Saimiri - Pra president jeni presidenti i të gjithëve?

Presidenti - Po, patjetër.

Saimiri - Edhe i qeverisë?

Presidenti - Patjetër edhe i qeverisë, sepse përderisa i kam dekretuar. Jam dhe i qeverisë.

Doktori - A? Je dhe i qeverisë?



EDITORIAL

NGA EDLIRA MUEDINI

Dilemat para një interviste

vijon nga faqja 1

...dhe i marrë me maturinë e duhur.

Problematika qëndron në rastin kur kjo tërheqje nga aplikimi vjen e pabazuar mirë dhe jo thellësisht e menduar. Argumentimi që shpesh kandidatët japin pas kontaktit me ta për tërheqjen e tyre nga aplikimi bazohet në informacionin që aplikantët mbledhin për punëdhënësin potencial, gjatë kohës së pritjes për intervistën e radhës. Ndosht që ky informacion të mos jetë motivues, ose mund të ngrejë tek ata mëdyshje mbi vendin e punës, kompaninë, trajtimin që do t'ju bëhet, etj. Natyrisht që referencat kanë vlerën e tyre në të tilla raste, por ajo që duhet tu kushtojnë rëndësi aplikantët në këto raste është që këto referenca duhen marrë nga burime të besueshme dhe për më tepër, ato duhet të verifikohen. Pavarësisht kësaj, përsëri do të thoja nuk duhet humbur mundësia e një interviste të drejtpërdrejtë me punëdhënësin potencial, e cila mund të ndihmojë më mirë në verifikimin e informacionit dhe në vendimarrjen e të dypalëve. A është me vlerë që të terhiqemi nga aplikimi pa u bazuar në mënyrë të saktë në të gjitha burimet e mundshme të informacionit? Personalisht mendoj se në vendimarrjen e duhur ndikojnë formimi ynë si dhe ambjenti në të cilin punojmë dhe jetojmë. Vendimarrjen për të ardhmen tonë profesionale ne duhet ta marrim duke konsideruar me realizëm të gjitha mundësitë që na ofrohen dhe duke përjashtuar vendimet emocionale të pabazuara.

www.shqiptarja.com

Presidenti - Po natyrisht. I kam dekretuar, i kam dhënë besim.

Saimiri - Po mund edhe të mos i dekretojë?

Presidenti - Po në varësi të gjykimit të presidentit. Patjetër hyn në atributet e presi-

dentit. Fakti që i kam dekretuar, nuk kam keqardhje. I kam dekretuar.

Saimiri - I ke dhënë bekimin?

Presidenti - Patjetër i kam dhënë bekimin në funksion të qeverisjes së të gjithë shqiptarëve.



Rama me krejt e PS: Homazhe më 21 janar, nisi viti elektoral

Afrimi i përvjetorit të parë të 21 janarit ka mbledhur në Tiranë krerët lokalë të PS të thirrur nga kryetari Edi Rama dhe kryetari i grupit parlamentar socialist Gramoz Ruçi. Homazhet që janë percaktuar si forma e përkujtimit të opozitës të ngjarjeve të 21 janarit një vit më parë, do mbledhin në Tiranë qytetarë nga të gjitha rrethet e vendit nën organizimin e PS. Prania e sa më shumë njerëzve është

synimi i opozitës, çka ka nisur me mobilizimin e drejtuesve të PS në rrethe që kanë marrë direktivat nga selia e PS për organizimin e qytetarëve që duan të jenë të pranishëm në Bulevardin "Deshmoret e Kombit", për të bërë homazhe e vene kurora me lule në vendet ku mbeten të vrare kater protestues në ngjarjet e një viti më parë. Ndërkohë që drejtuesit vendorë janë orientuar për turin e lidhshimit të PS

për programin e ri politik. Sipas Klosit, sekretari i organizimit tha se më 15 janar nis viti elektoral i PS, i cili përfundon në datën kur do të mbahen zgjedhjet e përgjithshme. Kritika e numrit të anëtarësive me 30% është një prej objektivave të vendosura nga Kongresi, ndërkohë që do të jepen tesera të reja në 100 vjetorin e pavarësisë për anëtarët më aktivë të partisë.

Kreu i qeverisë për "ABC": Më 21 janar, rrethuan kryeministrin

Berisha: Presidenti i PD, Topi s'na pyeti

"Pranoj kandidatin e Ramës, ai të pranojë të PD"

■ ■ ■ TIRANE

Si i konsideroni ngjarjen e 21 janarit...?

21 janari ishte një ngjarje e trishtueshme dhe një tentativë për të marrë pushtetin dhe që u zhvillua në sytë e gjithë botës. E rëndësishme është që gjatë gjithë kësaj periudhe është pritur dhe ka një komision parlamentar. S'dimë asgjë për hetimin për 21 janarit dhe s'ka asnjë të dhënë për autorët, sponsori-zuesit e ngjarjes. Askush nuk mund të mohojë se një Kryeministër u rrethua dhe se u përdorën format e dhunës. Ka një zinxhir pafund faktesh dhe shqiptarët folët për këtë ngjarje në 8 maj. Veridikti i shqiptarëve bëri që të nxirren në vendimet e duhura që solli marrëveshjen mazhorancë opozitë. Për zgjedhjet e 8 majit foli edhe Komisioni i Venecias.

Ambasadoret kanë mbështetur një president konsensual?

Respekti im për ambasadorët është shumë i madh, por respekti im për Kushtetutën dhe ligjet është absolut. Unë do të pranoj çdo kandidat të PS, por dhe PS duhet të pranojë çdo kandidat të PD. Pastaj kush të kalojë, është punë tjetër. Por Sali Berisha i qëndron Kushtetutës.

Zgjedhja e Presidenti me shumicë të thjeshtë...?

Me bekim të plotë të zotit Rama u ndryshua Kushtetuta.

Kërkesat për ndryshimet në Kushtetutë?

Opozita është në fazën e Kurbanit. E bëri Islamin kurban dhe e ka kërkuar punën e përbashkët çka do të thotë se jemi në pozita të përbashkëta. Përbërja e KQZ? Një opozitë që sulmon çdo ditë gjykatësit, si do të pranojë anëtarë të gjykatës në KQZ?!... Kushtetuta nuk i lejon gjykatësit të kenë pozicion tjetër.

Do ta ndryshoni sistemin zgjedhor?

Sistemi zgjedhor? Nuk pranoj asnjë ndryshim kushtetues. Sistemi aktual është një meritë e përbashkët me Edi Ramën, i cili përjashtoi disa pasoja gjeografike. Kërkesat për ndryshime, janë gjëja më joserioze se ndryshimi i Kushtetutës çdo 3-4 vjet. I bëmë disa ndryshime kushtetuese, megjithëse Rama



Kryeministri Sali Berisha

Presidentit nuk është për të bllokuar, por për t'u ushtruar. Nëse një president zgjedh për të bllokuar vetëm, sepse bëka pa mazhorancën është punë e tij, por bllokon vendin.

Po një koment për këtë periudhë që...?

Po të më kërkojë të më komentoj, do kisha gjëra për të thënë. Por kam vendosur që këto gjashtë muaj të hesht, sepse rrënohet institucionin, jo personi.

Kandidati për presidentin i ardhshëm?

Fjala ishte që Rama do të japë një kandidaturë. Por duhen disa firma për kandidaturën. Nëse fiton...

Do jetë kandidat një nga PD?

Presidenti do të jetë figurë politike, ai shkon për të bërë politikë në përputhje me Kushtetutën e vendit. PD ka disa drejtues të shkëlqyer, do të zyrtarizohet sapo të hapet gara.

Ju do kandidoni...?

Këta miq të mi, nuk e kanë të qartë që kundërshtarët e tyre mezi presin ta shohin Berishën kandidat për president, por nuk do ta shohin. Kam qënë president, me këto ndryshime që janë bërë unë u qëndroj atyre premtimeve që u kam thënë shqiptarëve, kam bërë një fushatë. I qëndroj fjalës. Nuk do të jem kandidat, ju garantoj

Po Topalli?

Unë tani flas për veten time, më vonë për të tjerët. Por sa e fshihem është që duke pasur presidentin në detyrë të dorëzohet kandidatit. Do të rrijë gjashtë muaj, në korrik, kandidati do shfaqet atëherë kur e thotë Kushtetuta. Është një proces serioz. Unë pranoj kandidaturën e PS, nuk e di nëse Rama është i gatshëm të pranojë kandidaturën e PD.

Ka pakënaqësi në PD?

Më 2009 një e katërta e deputetëve bnuh kandiduan. Unë jam i sigurt, janë pjesë e PD, por ka dhe të pakënaqur.

Po koalicionet...?

Kush është provuar më shumë se sa unë si unifikues koalicionesh, unë kam koalicionet më të gjera të vendit.

Mund të ketë Rama koalicion me partinë e Topit? Atë e thua ti.

Ka ngritur një proces, ka bërë një program, 21 grupe pune...?

I ka hyrë procesit të shkatërrimit me sukses të PS.

Nuk ju shqetëson një koalicion Rama-Topi?

Aspak nuk më shqetëson. Unë di se do të ngre koalicionin më të gjërë që ka patur vendi. Respektoj këdo në zgjedhjet e tij. Elektoratin do ta shohim në zgjedhje. Ky është një vend i lirë. Koalicioni ynë është më i suksesshëm.

Për Metën?

Qëndrimi që po mban zoti Meta i bën nder si politikan, dinjitetit të tij.

Në rast se fiton Meta do kthehet në qeveri...?

Do respektohet vendimi i drejtësisë. Meta, derisa të jepet vendimi është i pafajshëm, ai ka besim të plotë të gjykatës. Do jetë pjesë e qeverisë, ajo është çështje e LSI, si parti aleate.

Pretenca e prokurorisë e zbeh marrëdhënien në koalicion?

Unë gjykoj se prokuroria ka kryer një akt shumë të rëndë, duke mashtruar parlamentin në shkrepsën që ka kërkuar heqjen e imunitetit. Meqënsë Meta ishte hapur për ta dorëzuar, ne heshtëm për të mos e konsideruar presion. Por me mashtrimin që ka bërë, prokuroria ka bërë akt të pamoralshëm. Gjykatësia e lartë bëri shumë mirë.

Nga PD janë kërkuar ndryshime në qeverie?

Kemi dy praktikë, PS në 8 vjet ndërroi 74 ministra, praktike e shndërrimit të qeverisë në qeveri tregu karrikesh. Cilindo të kapësh del ish-ministër. Dhe unë kam ndryshuar, por jo këshut.



BLENDI KLOSI

"PS mbështet Referendumin kundër plehrave"



Një çështje tjetër që është diskutuar në këtë mbledhje ishte dhe referendumi i Aleancës Kundër Importit të Plehrave, që siç sqaron Klosi do të ketë mbështetje të plotë nga PS. "Nuk është politikë e fshehtë e PS. Ne e kemi deklaruar në Kuvend që jemi për një referendum, dhe po ashtu që sido që të shkojë procesi me referendumin, ligji i parë që do të shfuqizohet është ligji që ka të bëjë me importin e plehrave. PS është krejtësisht në mbështetje të plotë të Aleancës Kundër Importit të Plehrave duke i kërkuar të gjithë mbështetësit të PS që në të gjitha pikat ku do mbledhen firmat të ketë pjesëmarrje aktive", tha Klosi.



**PS dhe aleatët: KQZ
e balancuar, përbërja
mundësisht me gjyqtarë**

Socialistët dhe aleatët e tyre janë shprehur për një institucion të lartë zgjedhor të përbërë nga gjyqtarë. Kështu, opozita hedh hapin e parë për një kompozim ndryshe të KQZ, që sipas drejtuesve të selisë roze, duhet të garantojë një institucion të depolitizuar dhe pa influencë nga politika. Vetëm një ditë më parë në tryezën e aleateve janë hedhur disa nga formulat për

rikompozimin e institucionit zgjedhor. Spartak Ngjela ka propozuar gjyqtarë që do të vinin nga Gjykata e Lartë, në vend të anëtarëve të propozuar nga partitë. Kreu i PDS, Paskal Milo, pohon se përzgjedhja e anëtarëve të rinj të KQZ duhet bërë nga juristë me eksperiencë në këtë fushë, pa specifikuar nëse ata duhet ose jo të zgjidhen nga partitë. Një tjetër variant që është diskutuar, por që nuk është

finalizuar ende si vendim, është një institucion zgjedhor i balancuar politikisht. Vete bashkëkryetari i Komisionit për Reformën Zgjedhore, Damian Gjikhuri, prezant në takimin e së martës, nuk është prurë për variantin që do të zgjedhë PS për ta paraqitur në komision. Ajo që dihet është se javën e ardhshme propozimi për një KQZ të depolitizuar do të marrë formë.

Braçe: S'ka konkurs. Zot shpëtoje Meidanin nga varësia e mazhorancës

MAZHORANCA

"President sipas Kushtetutës, një nga figurat e PD"

Presidenti, përplasje në PS për "konkursin"

Gjermani: Gati përzgjedhja nga PS, sipas Kushtetutës

Lajmi

Socialistët ende s'janë të qartë në lidhje me përzgjedhjen e kandidatit për President, ndërsa më i godituri është ish-presidenti Meidani, i cili e ka cilësuar konkursin absurd. PS propozon një përzgjedhje transparente konform Kushtetutës, siç u bë me Avokatin e Popullit, procesin e vlerësuar nga ndërkombëtarët.

TIRANE

JAKIN MARENA

Zgjedhja e pasuesit të Bamir Topit në krye të shtetit pas gjashtë muajsh, përpos debatit që ka sjellë në politikën shqiptare, duket se ka krijuar paqartësi dhe në radhët e socialistëve. Të cilët në deklaratat e një ditë më parë, kanë pohuar dhe mohuar njëri tjetrin, ndërkohë që në qendër të goditjes ka qenë ish-presidenti socialist Rexhep Meidani.

Ndërsa nënkryetari i grupit parlamentar socialist Erjon Braçe i kujton ish-kreut të shtetit se nuk është thënë asnjëherë nga askush në PS se Presidenti do zgjidhet me konkurs, ka qenë anëtarja e kryesisë së PS, deputetja Gjermani ajo e cila për mediat ka deklaruar se propozimi për kandidatun e Presidentit do përzgjidhet në mënyrë transparente për t'ia paraqitur mazhorancës. Pra PS është gati ta bëjë një propozim të tillë, bazuar dhe në përvojën shumë të mirë të përzgjedhjes së Avokatit të Popullit, e cila u përshëndet dhe u vlerësua shumë nga ndërkombëtarët.

Por, dje Braçe nuk ka munguar të japë një përgjigje therëse për ish-presidentin Meidani, i cili në një koment për një të përditshme e kishte cilësuar zgjedhjen e Presidentit të ri me konkurs si diçka absurde. "Zot, na shpëto nga ata që s'lexojnë, por më shumë shpëtoje ish-presidentin nga varësia prej mazhorancës së sotme", deklaroi Braçe.

Sipas tij janë bërë dy deklaratat për çështjen e Presidentit, njëra ka të bëjë me atë që Presidenti s'duhet të jetë nga familja Berisha dhe nga Klani i tij që i garanton



Në foto: Eglantina Gjermani (lart) Erjon Braçe

jetën luksoze. Që sipas Braçes vjen nga mungesa e të lexuarit të Kushtetutës, pasi në të s'thuhet se si s'duhet të jetë Presidenti, por si duhet të jetë, përfaqësues i unitetit të popullit. "Ndërsa deklarata tjetër ka qenë që Presidenti me konkurs, absurd.

Deklaratë kjo brenda një shkrimi të gjatë pa lidhje por me honorar, vjen për shkak të varësisë së dukshme të ish Presidentit nga

maxhoranca e sotme. Kërkund, po e theksoj kërkund, qoftë edhe një njeri i vetëm, posaçërisht nga PS, s'ka thënë që Presidenti do zgjidhet me konkurs. PS i përmbahet frymës së Kushtetutës, 'President si përfaqësues i unitetit të popullit', e ky produkt, përmes një procesi përfshirës dhe të dialogut politik", tha Braçe. I cili ka bërë thirrje dhe njëherë në drejtim të ish-presidentit: "zot, bëji të lex-

ojnë por edhe të fitojnë pavarësinë e tyre nga honorari dhe mazhoranca".

Por në lidhje me presidentin, anëtarja e kryesisë Gjermani, deputetja që drejtoi procesin e përzgjedhjes së kandidatit Totozani për Avokat të Popullit tha se PS është gati të propozojë një kandidatun për President përmes një procesi përzgjedhës transparent që do synojë të ofrojë një emër gjit-

bëpërfshirës dhe me konsensus sa më të gjerë politik. "PS ka ngritur një grup pune dhe përzgjedhja dhe paraqitja e një kandidature presidenti konsensual, përputhet në fakt me vizionin që PS ka për përzgjedhjen e një figure, e cila do mishërojë unitetin kombëtar, do të ketë një profil sipas Kushtetutës, por përputhet edhe me interesat kombëtare", tha Gjermani.

Duke mos bërë të ditur

kriteret që do të vihen si kusht nga grupi i punës në selinë rozë. "Dua t'ju garantoj, është sërish një proces transparent, i cili do të vazhdojë për përzgjedhjen e kandidatit me një profil, sipas Kushtetutës, duke mos përjashtuar askënd, duke i dhënë mundësi gjithkujt, të jetë pjesë e këtij procesi dhe përzgjedhjen më pas të një figure, e cila do të jetë figura që PS ofron ose propozon për Presidentin", tha Gjermani.

Ambasadorja/Gjikhuri

Presidenti, Holtkemper: Mbështesim konsensusin

TIRANE

Zërvatë të diplomatëve të huaj që kozenojnë mbi zgjedhjen e presidentit të ardhshëm të vendit, u është shtuar edhe ambasadorja gjermane në Tiranë, Karola Holtkemper. Gjatë një vizite në qytetin e Burrelit, Holtkemper, tha se presidenti duhet të zgjidhet sipas rregullave dhe kushtetutës vendase, por nënvizoi se për pozicionin në fjalë, mirëpritet një kompromis mes palëve dhe se kandidatit duhet të ketë disa cilësi të vecanta për të qenë në krye të shtetit. "Presidenti duhet të zgjidhet sipas rregullave. Shqipëria e ka një Kushtetutë ku përcaktohet qartë se si zgjidhet presidenti, por ne mbështesim një konsen-



sus mes palëve për të gjetur një emër që ka cilësitë e vecanta për të qenë president", tha ambasadorja Holtkemper. Nga ana e tij, sekretari socialist për çështjet Zgjedhore, Damian Gjikhuri, flet për momentin e zgjedhjes së Presidentit të Republikës. Ai thotë për TCH se në tre raundet e para të votimit pjesëmarrja e 84 deputetëve është e domosdoshme jo vetëm për ta zgjedhur Presidentin, por edhe për t'i zhvilluar vetë seancat. Sipas Gjikhurit, kuorumi i cilësuar del nga interpretimi i frymës së Kushtetutës. "Për kryetarin e shtetit shqiptar, që është figura e unitetit, ka vullnet përtej një mazhorance të thjeshtë. Po të interpretosh Kushtetutën, ka vend për të dis-

kutuar, në vecanti për figurat e shtetit. Fakti që parashikohen tre raunde me shumicë të cilësuar tregon se Kushtetuta e ka pasur parasysh konsensusin. Ndryshe nuk kishte përse këto tre raunde të qundronin", tha Gjikhuri. "PS është shprehur se është për një dialog për të zgjedhur një figurë konsensuale. Nuk duam të bëjmë një luftë votimi në Parlament pa gjetur më parë një figurë të tillë. Për ne, dërgimi i çështjes në gjykatë është një debat i parakohshëm. Tani e rëndësishme është që të ulemi e të dialogojmë, pa paragjykuar asnjë emër. Çështja për t'i kërkuar mendim gjykatës është diçka që duhet parë, por në kohën e vetë", thekson Gjikhuri.



Qeveria dëmshpërblen investitorët me 1.9 mln USD

Këshilli i Ministrave ka vendosur dje të paguajë 1.86 milionë dollarë në formë detyrimi për investitorët italianë I.C.M.A. s.r.l dhe AGRIBEN. s.a.s., ortakë në ish-shoqërinë e përbashkët "Pranvera" sh.p.k., Sukth, Durrës. Për vlerën është rënë dakord më negociim me këta investitorë dhe ajo do të paguhet nga fondi rezervë i buxhetit të

shtetit për vitin 2012. Historia e kësaj shoqërie nis në nëntor të vitit 1992, kur italianët nga Mantova morën me koncesion për 90 vjet 600 hektarë troje bujqësore në Hamallaj, Sukth e Rushkull, me qëllim prodhimi dhe eksporti të produkteve bujqësore e blegtorale, por më pas gjithshka u ndërpre për faj të palës shqiptare. Për

disa vjet, pati konflikte mes dy palëve dhe procesi u ndërpre më 1997. Më pas, në këtë rajon u krijua një kamp për refugjatët e luftës së Kosovës dhe u ndërta banesa pa leje, duke e bërë të pamundur rifillimin e operacioneve bujqësore. Pala italiane kishte kërcënuar me gjyq, por qeveria ka pranuar të paguajë dëmshpërblim

Qeveria shqiptare nis procesin e licensimit të lotarisë së re

Gati gara për lotarinë kombëtare

Një shoqëri kanadeze ka zbarkuar në Tiranë për t'u interesuar për licencën e lotarisë kombëtare. Por për këtë nuk ka patur transparencë nga organet kompetente

Lajmi

Këshilli i Ministrave ka vendosur dje kriteret e vlerësimit të garës, të dokumenteve standarde dhe strukturës së Komisionit të Vlerësimit të Aplikimeve, për dhënien e licencës për lotarinë kombëtare. Ministria e Financave do ta zbatojë këtë vendim

TIRANE
GENC KONDI



kombëtare, të paktën në një gazetë të huaj, me qarkullim ndërkombëtar, në dy gazeta, që botohen në vendin tonë, në dy numra radhazi, si dhe në Buletinin e Njoftimeve Publike

Çdo person juridik apo bashkim personash juridikë, vendas ose të huaj, ka të drejtë të aplikojë për t'u pajisur me licencë për lotari kombëtare. Aplikanti duhet të jetë i organizuar në formë shoqërie aktionare apo bashkim shoqërisht, me kapital jo më të vogël se 1.2 miliardë lekë, nuk duhet të jetë në falimentim, të ketë përvojë jo me pak se tre vjet në këtë fushë.

nga ligji për të dhënë licencën "Lotari kombëtare" është ministria e Financave, ndërkohe që më parë këtë të drejtë e kishte ministria e Ekonomisë.

Deri tani, është mësuar se një shoqëri kanadeze ka zbarkuar në Tiranë për t'u interesuar për licencën e lotarisë kombëtare. Por për këtë nuk ka patur transparencë nga organet kompetente shqiptare. Drejtuesit kryesorë të kompanisë kanadeze kanë shpjeguar se, nga viti 2008,

një periudhë 10-vjeçare. Kjo licencë është një e vetme dhe i jepet aplikantit, i cili përzgjidhet i pari në procesin e konkurimit. Në të përfshihen të gjitha lojërat numerike, ku një numër është tërhequr nga një radhë e paracaktuar numrash "Kenô", si në formën tradicionale, ashtu edhe në atë

elektronike si dhe lotari, për të cilat hidhet short, ku lojtari synon të fitojë një shumë të caktuar, nëse nga hedhja e shortit, që bëhet në mënyrë

publike, fiton numri, që shënohet në biletën e zgjedhur prej tij.

Nga ana tjetër, përfshihet edhe lotaria e castit, ku lojtari i ofrohet mundësia të bëjë vetë shirjen e shiritit mbulues të numrit të shënuar, brenda një intervali kohor të caktuar, gjatë të cilit është e vlefshme seria e biletës së lotarisë.

Aplikanti për marrjen e licencës për lotarinë kombëtare duhet të paguajë menjëherë një shumë prej jo më pak se 300 milionë lekësh dhe gara për dhënien e licencës për lotarinë kombëtare hapet pas autorizimit të dhënë me vendim të Këshillit të Ministrave.

Ministria publikon njoftimin për konkurrim në lojërat e fatit për lotari

Në muajin maj 2010, në Tiranë ka ardhur pikërisht për të tatuar pulsën e tregut shqiptar zëvendës-presidenti i kompanisë "Atlantic Lottery Corporation", Daigle

vendi ynë ka reformuar tregun, duke ndryshuar ligjet dhe aktet nëligjore për sektorin e lojërave të fatit, ku përfshihet edhe dhënia e një licencë të vetme me përmasa kombëtare një subjekti, vendas apo të huaj, që mund të jetë i vetëm, apo mund të paraqitet si një bashkim subjektesh.



BANKERS PETROLEUM ALBANIA LIMITED

JOB ANNOUNCEMENTS

Bankers Petroleum Albania Ltd (Bankers) is a subsidiary of Bankers Petroleum Ltd, a Canadian oil & gas company headquartered in Calgary, Alberta. We are listed on the Toronto stock exchange and also on AIM London. Our web address is www.bankerspetroleum.com

Bankers has its plans for the development of the Patos-Marinza and Kucova oilfields approved by the Government of Albania. We are also pursuing additional oilfield development opportunities in Albania. The Shareholders, Management and Employees of Bankers are extremely excited by the challenging prospects and opportunities which lie ahead. Having already experienced 5 successful years and established ourselves as the leading oil company in Albania, Bankers will continue to make significant investment in its oilfields in the years to come, with demanding targets for increases in reserves, production, and sales.

To help us meet our objectives, we are continually looking to add suitably qualified people who can demonstrate qualities including enthusiasm, initiative, team-working, leadership and humility. Bankers' offers competitive compensation and benefits and has a culture of rewarding good performance. We are committed to the principle of equal opportunity in employment and promote a fair and non-discriminatory work environment.

We are currently looking for qualified candidates to fill the following vacant position. Whilst candidates may not have all the necessary experience, the Company is prepared to train and develop the right people to fulfil the requirements of this position.

1. Community Relations Coordinator

Community Relations Coordinator is a full time position and under the direction of the company's two Social Managers, will coordinate the Community Relations team to:

- Fulfill the company's compliance obligations in relation to IFC/EBRD performance standards; and,
- Accelerate Company's community investment program and individual projects.

Other Responsibilities:

- Identification and mitigation of potential social risks to our company;
- Stakeholder engagement to establish healthy relationships with communities;
- Overseeing of social impact baseline and impact analyses;
- Development and implementation of a Community Investment Program;
- Strengthening of relationships with other divisions of the company to enable a sustainable development approach to our activities.

Key Requirements:

- Bachelor Degree in Social Sciences.

- At least 8 years of experience in social impact assessment/social sciences, preferably related to extractive industries (oil experience is an advantage).
- He/she should be a collaborative "team builder".
- International experience will be viewed favourably.
- Demonstrated ability to manage staff is also an important skill.
- Very good knowledge of English language (spoken and written).
- Very good knowledge of Microsoft Office package.
- Self motivated, energetic, good planning, reporting and organisation skills.
- Excellent communication and interpersonal skills.

Applications including a C.V. and cover letter, preferably in English, should be sent in a sealed envelope to the Human Resources Department at the following address:

Lagjia "Sheq i Madh", Rruga "Leonardo Murialdo", Fier
Tel no: +355 (0) 34 220 845 / 6 / 7 / 8
Fax No. +355 (0) 34 220 850

or by E-mail to: humanresources@bankerspetroleum.com

The deadline for submitting applications is January 15th, 2012. All applications will be considered, and responses sent out as soon as possible.

Hipoteka

Çfarë nevojitet për transaksionet

TIRANE

Në rast shitje, dhurim, vendim gjykatë për fitim pronësie, vendim të përbaruesit gjyqësor, trashëgimi, shkëmbim, heqje dorë nga pasuria, pjesëtim i pasurisë, ndërrim emri, në të gjitha transaksionet e mësipërme, të cilat lidhen me kalimin e pronësisë së regjistruar më parë në Kartelën e Pasurisë së Paluajtshme (KPP) dhe në Hartën Treguese të Regjistrimit (HTR), duhet të jetë shprehur kalimi i pronësisë nga subjekti i regjistruar në KPP tek subjekti tjetër. Në të kundërt dokumenti për kalimin e pronësisë nuk mund të regjistrohet. Këto rregulla njoftohen së fundi nga Hipotekat, me qëllim sensibilizimin e qytetarëve. Gjithashtu, nëse ka regjistrime (harrë) të regjistruara në KPP dhe HTR, ato duhet të jenë shpre-



Hipoteka e Tiranës

hur në dokumentin e kalimit të pronësisë, në të kundërt dokumenti nuk mund të regjistrohet. Dokumentat e nevojshme për këto transaksione janë dokumenti i kalimit të pronësisë, bashkëlidhur kopje e KPP dhe HTR, si dhe, nga ana tjetër, certifikata e pronësisë. Afati i kryerjes së regjistrimit është 8 ditë. Produkte për fituesin e pronësisë mbi pasurinë janë certifikata për vërtetimin e pronësisë, kopja e kartelës së pasurisë së paluajtshme dhe kopja e hartës treguese të regjistrimit. Hipoteka thekson se nuk mund të bëhet kalimi i pronësisë vetëm të një pjesë të pasurisë së paluajtshme. Më parë duhet të bëhet ndarja e pasurisë dhe të regjistrohet dokumenti i ndarjes duke hapur kartela të reja për çdo nëndarje. Pas kësaj bëhet kalimi i pronësisë për nëndarjen e kërkuar.



Turqia: Shtohet droga që kalon tranzit përmes Shqipërisë

Duke pasur parasysh vendndodhjen e saj strategjike midis Evropës, Azisë Qendrore dhe Lindjes së Mesme, Turqia vepron si një rrugë tranzit për trafikun e drogës nga Irani apo Afganistani në vendet evropiane. Ku rreth 80% e heroinës afgane kalon përmes Turqisë, e më tej përmes Ballkanit në rrugën e saj drejt Evropës Perëndimore, e cila cilësohet si "Rruga Ballkanike" sipas OKB-së. Kështu nis një

artikull i posaçëm i medias turke "Turkish Weekly" lidhur me rrugën që ndjek trafiku i drogës, ku Shqipëria gjithashtu si një vend kyç tranziti. Ai citon të flasë edhe Hamid Ghodse, president i Bordit Ndërkombëtar të Kontrollit të Narkotikëve të OKB-së, sipas të cilit, "rruga nga Ballkani mbetet një korridor kryesor i trafikimit të heroinës në vendet evropiane". Duke shtuar se "ka një diversitet në rritje mbi

metodat dhe rrugët e përdorura në trafikimin e heroinës në Evropë". Për vitin 2010, Ghodse thotë se sasia e heroinës së konfiskuar në Evropë, e trafikuar përgjatë Rrugës Ballkanike Veriore përmes Turqisë, Bullgarisë, Rumanisë, Hungarisë dhe Austrisë ka shënuar rënie, në krahasim me Rrugën Ballkanike Jugore që kalon për në Itali nëpërmjet Greqisë, Shqipërisë dhe Maqedonisë.

Drejtori i Policisë Rrugore, Vullnet Topalli sqaron ndëshkimet

Kodi Rrugor, ja si do ndëshkohen shkelësit

Sqarohen masat e reja ndaj kundravajtësve

Lajmi

Drejtori i Policisë Rrugore, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, Vullnet Topalli, ka sqaruar dje në një intervistë ndëshkimet e reja që do të bëhen ndaj kundravajtësve të Kodit Rrugor, pas ndryshimeve që hynë dje në fuqi.



Duke qenë se situata në rrugë po bëhet tejet e pasigurt për shkak të shkeljeve të kryera nga drejtuesit e papërgjegjshëm të automjeteve, konkluduar se vënia në zbatim e rregullave të reja do të krijonte një gjendje më të sigurt. Për këto ndryshime që u kryen, patëm mbështetjen e partnerëve ndërkombëtarë që mbështesin Policinë e Shtetit. Nga eksperienca në vendet e Europës dhe më gjerë, konstatuar se gjohat e mëdha dhe masat e rrepta ndëshkimore kanë sjellë një respektim rigoroz të rregullave të qarkullimit rrugor. Dhe për pasojë, siguri në rrugë. Këto dhe të tjera që përmenda dhe pak më parë ishin arsyt që na shtynë të rishikim kodin.



Drejtori i Policisë Rrugore, Vullnet Topalli

Si mund të reagojnë drejtuesit e automjeteve nga këto masa ndëshkimore, a keni ndonjë pritshmëri?

Qëllimi ynë është të zbatohet me përpikmëri Kodi Rrugor dhe të shmangim aksidentet dhe jo të vendosim sa më shumë gjoha. Pikërisht për të shmangur këtë, përpara se të niste zbatimin e kodit të ri, nisëm të bënim fushatë të gjerë në media dhe opinion publik. Në një farë mënyre, mendojmë se drejtuesit e automjeteve janë të informuar për ndryshimet e reja dhe janë sensibilizuar për masat që do të marrin nëse i shkelin rregullat. Pra, jemi përpjekur të bëjmë një parapritje, që të

shmangim problemet që mund të hasin sot drejtuesit e mjeteve kur të përballen në akset rrugore me patrullat e policisë.

Cilat janë raportimet e para nga terreni?

Drejtorja e Policisë Rrugore po komunikon në vijimësi me të gjithë sektorët dhe patrullat në qarqe për të krijuar një ide të qartë të gjendjes. Deri më tani, janë raportuar disa raste të shkeljeve si dhe masave ndëshkimore të aplikuar. Por, duke qenë se janë ende orët e para të operacionit nuk mund të jap statistika të sakta. Në fund të ditës së sotme besoj se do të kem të përpunuara të dhënat për të dalë në një shifër zyrtare.

TIRANE

Policia rrugore ka nisur në orët e para të mëngjesit të mërkurës inspektimin e të gjitha akteve kombëtare në vendin tonë. Ka nisur kështu edhe aksioni policor për ndëshkimin e shkelësve të Kodit Rrugor, i shoqëruar me masa më të rënda ndëshkimore. Për të pasur një tablo më të qartë të situatës, agjencia e lajmeve NOA.al ka realizuar një intervistë me drejtorin e Policisë Rrugore, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, Vullnet Topallin.

Sot është dita e parë e zbatimit të rregullave të reja të Kodit Rrugor. Ju lutem mund të na jepni ndonjë informacion më të detajuar lidhur me këtë?

Që në orët e para të mëngjesit, në të gjithë akset kombëtare të vendit tonë, janë dërguar forca të shumta të policisë rrugore. Gjatë këtyre ditëve të fundit kemi rakorduar punën me njësitë në të gjithë qarqet e vendit, në mënyrë që të gjithë rrugët të jenë të inspektuara për të vërejtur zbatimin e rregullave të reja. I gjithë stafi drejtues i Policisë së Shtetit është i interesuar dhe preokupuar për zbatimin e rregullave të reja, në mënyrë që rrugët të jenë të sigurt si dhe të ulët apo eliminohet numri i aksidenteve. Për të qenë sa më transparentë kemi ftuar dhe median lokale e atë kombëtare. Në këtë mënyrë, mendojmë të shmangim pretendimet e drejtuesve të mjeteve për gjokitje pa të drejtë. Transparenca e mediave do të jetë një provë e qartë e qëllimit të policisë, që konsiston në vënien para ligjit të

atyre që shkelin rregullat dhe cënojnë sigurinë në rrugë dhe jetën e qytetarëve.

A mendoni se masat e reja do të ulin numrin e ak-

sideve dhe do të krijojnë siguri në rrugët kombëtare?

Duhet të theksoj se Drejtorja e Policisë Rrugore ishte ajo që inicioi rishikimin e masave për shkelësit e Kodit Rrugor.

Abonohu!

Për t'u abonuar ju lutemi kontaktoni me:
To Subscribe please contact:

ADRION Ltd
Tel: +355 4 2240018
e-mail: sales@adriionltd.com

Agjencia e Abonimeve të Shtypit (TRENOVA)
Tel: +355 682047825
e-mail: arbentreno@yahoo.com



[SHQIPTARJA.com]



ENERGJIA ELEKTRIKE

CEZ Shpërndarje njoftoi se për shkak të një defekti të Operatorit të Sistemit të Transmetimit ka patur ndërprerje të alternuara të energjisë për zonat Unaza e Re, Yzberisht, Kashar, Misto Mame, Kamëz, Vorë. Për shkak të mbingarkesës OST i ka kërkuar CEZ-it ndërprerje edhe për periferitë dhe fshatrat në Tiranë, Lushnjë, Fier, Vlorë, Gjirokastr dhe Sarandë



KRIZA NE EUROZONE

Kritika ekonomike në tremujorin e tretë të vitit 2011 në zonën euro ishte +0,1 për qind, njoftoi Eurostat. Aktiviteti ekonomik është tkurrur në shtatë vende të zonës euro: Belgjika (-0,1 për qind), Qipro (-0,7 për qind), Italia (-0,2 për qind), Portugalia (-0,6 për qind), Holanda (-0,2 për qind), Sllovenia (-0,2 për qind) dhe Irlanda (-1,9 për qind) në ritëm vjetor

Qeveria: Vëmendje për sektorin e prapambetur

Bujqësia, Berisha OK kooperativave

I jepet 3 për qind e buxhetit të shtetit

Lajmi

Kryeministri Berisha, në mbledhjen e djeshme të qeverisë, ka njoftuar paraprakisht marrjen e vendimit për krijimin vullnetar të shoqërive bujqësore për rritjen maksimale të rendimenteve, për gjetjen e aktimitin e tregjeve më të leverdishme dhe marketingun më të mirë

NDARJA E BUXHETIT TË SHTETIT PËR VITIN 2011 SIPAS SEKTORËVE NË MIJË LEKË		
Institucioni	Fondi	
Ministria e Ekonomise, Tregtise dhe Energjitikes	2,613,660	1.00%
Ministria e Bujqesise, Ushqimit dhe Mbrojtjes se Konsumatorit	7,961,788	3.05%
Ministria e Puneve Publike dhe Transportit	48,487,269	18.55%
Ministria e Financave	7,561,366	2.89%
Ministria e Arsimit dhe Shkences	40,394,457	15.45%
Ministria e Turizmit, Kultures, Rinise dhe Sporteve	3,392,104	1.30%
Ministria e Shendetesise	29,617,565	11.33%
Ministria e Drejtises	6,468,680	2.47%
Ministria e Puneve te Jashtme	2,263,516	0.87%
Ministria e Brendshme	16,275,841	6.23%
Ministria e Mbrojtjes	21,604,500	8.26%
Ministria e Punes, Ceshtjeve Sociale dhe Shanseve te Barabarta	50,411,000	19.28%
Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit te Ujrave	1,886,071	0.72%



OPOZITA

Edi Rama: Bujqësia, në gjendje mesjetare

Kryetari i Partisë Socialiste Edi Rama ka shfrytëzuar rrjetin social Tëitter për të publikuar një tjetër koment ndaj qëndrimeve të shfaqura dhe prej kryeministrit Sali Berisha lidhur me politikën qeveritare për sektorin e bujqësisë. "Bujqësia qenka sot prioritet i qeverisë? Në fakt, bujqësia është në gjendje mesjetare dhe vetëm programi ynë e nxjerr atë nga kënetat e sotme. Edhe kanalizimet, thotë Saliu! Në fakt, keqkëqerisja e tij e ka bërë Shqipërinë truall gropash septike e përmytjesh, si në Afrikën tropikale", shkruan Rama. Opozita po i kushton një vëmendje të veçantë problemeve të fshatit.

Ajo u shfrytëzua për synime politike. Aktualisht, ka qenë qeveria spanjolle që ka dhënë në Shqipëri kontributin e saj për konsulentin lidhur me rigjallërimin e organizmave të lla. Dje, Berisha ka bërë thirrje për dixhitalizimin e

fshatit, duke kështuar gjithnjë nevojën për ecurinë e shpejtë në programet e rritjes së ullinjve dhe të drurëve arrorë. Sipas tij, ujitja dhe infrastruktura financiare në zonat rurale duhet të jenë përparësi e politikave bujqësore.

Etënë me fjalë të tjera, këto bashkime vullnetare janë kooperativat bujqësore, natyrisht mbi një bazë të ndryshme nga ajo e ish-kooperativave të para 1990-ës. Një gjë e tillë është kërkuar nga BE-ja, duke qenë se kooperimi në bujqësi rrit prodhimin. Që përpara se Partia Demokratike dhe koalicioni i djathtë të vinin në pushtet, Komiteti Orientues i Politikave (KOP) i PD, ndër idetë e shumta, që ishin hedhur lidhur me zhvillimin e politikave bujqësore, kishte lënë të kuptohet, në mënyrë tepër të ndrojtur, se qeveria e re do të ishte në favor të kooperimit në bujqësi.

Kështu, u përfshi në Programin e Ekzekutivit, teza se "Do të zgjerohet dhe përmirësohet shërbimi i këshillimit dhe mbështetjes së iniciativave kooperuese të fermerëve". Kjo u pasua edhe nga disa premtime të tjera, si "do të bëhet ristrukturimi i plotë i shërbimit veterinar dhe do të jepen këto shërbime falas"; "karburanti për konsum bujqësor do të sigurohet me një çmim prej jo më shumë se 40 lekësh për litër, për të gjithë fermerët shqiptarë"; "do të shumëfishohet akses në sistemin e kreditit nëpërmjet zgjerimit të skemave të mikrokreditit e deri tek banka e zhvillimit agrar", etj.

Të gjitha këto prem-

time kanë mbetur vetëm në letër deri tani. Për më tepër, për bujqësinë buxheti i shtetit parashikon shifra jashtëzakonisht të ulta. Kooperativat bujqësore ishin njësi prodhuese që kanë dhënë kontribut të njohur për zhvillimin e bujqësisë shqiptare. Defektet e tyre kryesore nuk ishin të karakterit ekonomik, se sa të shkaktuara nga ndërhyrja e politikës në çështje strategjike ekonomike. Padyshim ato kanë pasur edhe defekte, sidomos në shpërndarjen e të ardhurave. Në fund të viteve '80, ato kish-

kooperimi krijon kushtet për krijimin e fermave më të mëdha, pa të cilat nuk mund të ketë një ekonomi të zhvilluar bujqësore

in nevojë që të riorganizoheshin mbi baza të reja. Por, në vend që të punohej në këtë drejtim, ecuria e tyre i la spontani-

tetit. Kështu, që para kalimit në demokraci, u bë gjë e zakonshme që më i forti të rrëmbente ç'të gjente nga inventari i pasurisë kolektive: bagëtitë, drithin, deri materialin e zyrave e të stallave. Kooperativat bujqësore u panë nga shumica e popullsisë si simbol i një kolektivizimit të dhunshëm, që mishërohej në një subjekt që ishte jashtë individëve, që ata e shihnin si të huaj. Sipas ekspertëve, prishja e kooperativave në logjikën e grabitjes nuk ishte në dëshirën e fshatarësisë.

Regimi

Ish-ministrja: 20 vjet abuzime në bujqësi

TIRANE

Sipas ish-ministres së Bujqësisë Themie Thomai, kthimi i vëmendjes tek kooperimi është një ide e mirë. Është rruga e vetme për të rritur prodhimin, ulur çmimet në treg, për të riafruar fshatarin me tokën, me vendin e tij të lindjes, thekson ajo. Por, duke shtuar se, pas 20 vjet abuzimesh me lënie djerrë të sipërfaqeve të mëdha arash e dëgjie e shpërdorim kullotash e pyjesh, është skeptike për realizimin nga qeveria të një nisme të tillë. "Fshatari do ta ketë të vështirë të sqarohet se përsëri tokën do ta bashkojë me të tjerë. Le të bëhen disa kooperativa



Themie Thomai

pilot, që të tregojnë efektin e tij. Në perime, frutikulturë e blegtori, shanset janë më të mëdha për sukses", ve ajo në dukje. Efektivitetin e kooperimit në bujqësi e kanë treguar, sipas saj, edhe përvojat izraelite, italiane, franceze, e më gjerë. Por, ai i mëparshmi tek ne ishte një tip "artel", ku barazoheshin edhe mundësitë për të marrë të ardhura, duke e ulur interesin e individit. Kooperativat u tej-zmadhuan; mekanizmat financiarë të shtetit shkëlqim ligjet, duke marrë fonde nga kooperativat, apo duke caktuar vlerën e ditës së punës. Gabim i madh ishte përhapja e kooperimit të nxitur në zonat malore, ku vlera e ditës së punës

mbeti shumë e vogël. Po kështu, hapja e tokave të reja u bë në një mënyrë që dëmtoi raportet e natyrës. Që të mos flasin, pastaj, për ndërhyrjen e politikës, nga lart, nga qendra, në të gjitha problemet, edhe aty ku duhej të flisnin vetëm specialistët, thekson Thomai. Por, bashkimi i tokave, mjeteve dhe forcave bëri të mundur që bujqësia të trajtohej masivisht, dmth u krye bonifikimi, ujitja, vaditja, trajtimi me fara elitë apo plehra kimikë në shkallë pothuajse industriale. U vu nën ujë psh 65% e tokës bujqësore. U zhdukën shumë sëmunde. Toka u trajtua si një pasuri kombëtare. Këto nuk mund të arrihen me parcelizimin aktual, thotë ajo.



SOCIALE



BANESAT SOCIALE NË SHKOZË
Banesat në Shkozë janë krenjtësish të zbrazura. Asnjë nga familjet që i përkasin këtij blloku palatesh nuk kanë marrë çelësat në dorë.




ARSIMI SHQIPTAR NË LONDËR
Ministri i Arsimit, Myqerem Tafaj, i pranishëm në Forumin Botëror të Edukimit 2012 që po zhvillohet në Londër, ka folur për sfidat e arsimit në vendin tonë.

Behar Gjoka: Programi orientues i Letërsisë, jo në përputhje me atë të lëndës Matura 2012, nxënësve u kërkohen libra artistikë që si kanë bërë fare

Lajmi

Programi orientues i lëndës së Letërsisë nuk është në përputhje me atë që nxënësit kanë mësuar gjatë gjithë viteve të gjimnazit.



Në foto: Behar Gjoka studiues i letërsisë

kollë të mesme. Dhe kjo ka ardhur pasi në shkollën e mesme, që prej disa vitesh gjuha është e bashkuar me letërsinë.

Dhe këtu mësuesit janë të dyzuar. Mes dëshirës së tyre për të zhvilluar më shumë orë letërsie, meqë atë njohin më mirë dhe asaj çka u kërkon programi. Kjo ka gjë është reflektuar edhe në programin orientues që ka përcaktuar ministria e Arsimit.

Duke e krahasuar me programin orientues të maturës shtetërore 2011, ku letërsia zinte 80% të studimit në raport me kulturën gjuhësore, ai na thotë se programi i maturës 2012 është shumë më i mbingarkuar. "Gjatë maturës 2011, fragmentet për koment ishin pak a shumë të përcaktuara, ndërsa në maturën 2012, nuk ka fragmente të përcaktuara dhe i kërkohet të ketë lexuar shumë më shumë libra. Ta zemë, si mund të jetë në

gjendje një nxënës të komentojë një poezi nga "Palimpsesti" i Camajit, nëse ai nuk ka studiuar parimet krijuese të autorit dhe të poezisë reflektive e hermetike? - thotë ai.

Sipas tij ky program orientues në të vërtetë është një shmangie nga programi që gjimnazistët kanë bërë gjatë viteve të shkollës së mesme, ndaj ai duhet të korrigjohet, në të kundërt ose të gjithë maturantët do të penalizohen nga nota, ose Ministria do të jetë e detyruar që të hartojë një tezë të lehtë për të marrë rezultate të mira.

TIRANE
ESMERALDA KETA

Të gjithë ata që do i nënshtrohen këtij vit maturës shtetërore do ta kenë shumë të vështirë. Kjo pasi, në programin orientues të Letërsisë, i cili është publikuar vetëm pak ditë më parë, vihet re se në të janë përfshirë shumë më shumë tema, libra a pjesë për koment, të cilat gjimnazistët nuk i kanë zhvilluar.

Gjatë procesit mësimor përgjatë gjithë viteve të gjimnazit nxënësi është i detyruar të lexojë 3-5 libra, vepra letrare ose joletrare, të gjinive të ndryshme, shqiptare apo të huaja, të periudhave të ndryshme, sipas kurrikulës. Pra për tre vitet duhet të ketë lexuar maksimumi 15 vepra, ndërkohë që në këtë program orientues iu kërkohet të kenë lexuar 30 vepra. Vetëm "Vepra" e Ernest Koliqit është me 5 vëllime? Romani "Kënga Shqiptare" e Trebeshinës është me 5 vëllime? Mua si mësuese më lind e drejta të dyshoj: A i kanë lexuar vetë koto libra autorët e programit të maturës shtetërore që ua kërkojnë maturantëve? - na thonë një grup mësuesesh të lëndës së Letërsisë që janë shumë të shqetësuara pasi nuk dinë se si do t'i përgatisin të rinjtë.

Sipas tyre ajo që është më thelbësorja, ky program nuk ka respektuar as raportin tekst letrar me atë joletrar, duke qenë se në shkollë letërsia është e bashkuar me gjuhën. "Një gjatë tri viteve të shkollimit (të lexuarit) teksti letrar zë 45% të lëndës dhe ai joletrar zë 55%,

VLERËSIMI

Nuk është përcaktuar qartë as mënyra e vlerësimit

Mësuesit shprehen të pakënaqur edhe nga mënyra se si është menduar të vlerësohen nxënësit. Sipas tyre, objektivat e shënura nga specialistët e arsimit në të vërtetë nuk janë objektiva të matshëm, ndaj nuk ka siguri për vlerësimin. "Një ndër objektivat është: të dijë të shkruajë mirë. Po çfarë kuptohet me të? Ta zemë kanë parasysh gabime drejtshkrimore? Nëse vë tre presje gabim sa pikë i ulen? Për ne ka shumë gjëra që nuk shkojnë në këtë program orientues dhe në fund ata që do të penalizohen do të jemi ne mësuesit dhe nxënësit", - ankojnë mësuesit e Letërsisë.

në programin orientues ky raport është përmbysur, tekstet letrare zënë 60% të totalit dhe ai joletrar zë vetëm 40%. Dhe kjo është absurde", - na thonë më tej ata.

Behar Gjoka, studiues i letërsisë na thotë se në të vërtetë programi i shkollës për gjimnazistët dhe programi orientues i lëndës së Letërsisë nuk janë në të njëjtën linjë. Madje sipas tij, maturantët me programin që kanë aktualisht në dorë, iu kërkohet të mësohet dyfishi i asaj që kanë bërë në shkollë.

Është e vërtetë se programi orientues i Letërsisë është shumë më i mbingarkuar se sa programi që gjimnazistët kanë bërë në sh-

Punësimi i femrave

Lehtësi për pagat dhe sigurimet

TIRANE

Qeveria ka vendosur të ofrojë lehtësi fiskale për të gjithë bizneset që punësojnë femra të papuna. Sipas vendimit të qeverisë ata një marrin këto femra në punë, me një kontratë një-vjeçare do të përfitojnë: financim për një vit, në masën 100% të sigurimeve të detyrueshme shoqërore dhe shëndetësore të pjesës së punëdhënësit; financim për katër muaj, në masën 100%, të pagës minimale në shkallë vendi, në muajt e pestë e të gjashtë dhe të njëmbëdhjetë e të dymbëdhjetë të kontratës; punësimin deri në 100% të numrit aktual mesatar të të siguruarve (të 3

muajve të fundit përpara aplikimit), për mikrondërrmarrjet, dhe deri në 50% për ndërmarjet e tjera. Këshilli i Ministrave ka përcaktuar se në kategorinë e femrave nga grupe të veçanta do të klasifikohen: femra të papuna për një periudhë

Lajmi

Inspektorët do të verifikojnë rregullisht ecurinë e projekteve që do të shpallen fitues dhe nëse gjithçka ka ecur sipas rregullave atëherë ata mund të aplikojnë sërish vitin e ardhshëm, në të kundërt nuk do të mund të përfitojnë lehtësi më vitin tjetër.

afatgjatë (të regjistruara, si punëkërkuar i papunë prej më shumë se një viti); femra që përfitojnë nga programet e mbështetjes me të ardhura; femra të trafikuar; femra mbi 50 vjeç; femra rome; femra me aftësi të kufizuara; vajza nëna; femra të divorcuara me probleme sociale si dhe femra që kthehen nga emigracioni, me probleme ekonomike. Gjithashtu vendimi i qeverisë ka përcaktuar edhe rregullat që duhen respektuar për të përfituar nga këto lehtësi. Një ndër kriteret kryesore është që punëdhënësi, nuk duhet të ketë shkelur në të kaluarën legjislacionin e punës, verifikuar nga Inspektorati i Punës, si dhe duhet të ketë derdhur rregullisht tatimet e sigurimit e detyrueshme shoqërore dhe shëndetësore, veçanërisht për vitin e fundit.

PYETJE PERGJIGJE

Çfarë ka ndodhur me programin e maturës? Vetëm pak ditë më parë Ministria e arsimit dhe Shkencës ka publikuar programin orientues të maturës shtetërore për lëndën e Letërsisë. Mësuesit dhe studiuesit janë kundër këtij programi, pasi sipas tyre ai nuk respekton programin mësimor që kanë bërë në të vërtetë nxënësit nëpër shkollë. A kanë ata pretendime konkrete? Po! Ata shpjegojnë se nëse gjatë tre viteve të shkollës së mesme të rinjtë duhet të kishin lexuar maksimumi 15 vepra, në programin orientues iu kërkohet që të kenë lexuar plot 30 vepra. Gjithashtu po sipas tyre, në këtë program nuk janë përcaktuar as fragmentet që mund të bien për koment, duke qenë se libri nuk ka qenë i detyrueshëm. Po vitit e tjera si ka qenë? Ata shprehen se programi orientues i maturës 2012 është shumë më i mbingarkuar se ai i maturës 2011, ku si për ironi, letërsia zinte edhe më shumë vend. Ndërkohë që sipas tyre këtë vit nuk respektohet kjo ndarje.



RRITJE TË BILETËS PËR NË RRETHE
Drejtesit e autobusëve të rretheve deklarojnë se do të kërkojnë rritje të çmimit të biletës me 20%. Kjo pasi me rritjen e çmimit të karburantit, pas 1 janarit, ata po shkojnë drejt fallimentit. Madje ata kërcojnë edhe me protesta masive nëse nuk merren masa për largimin e furgonave të palicencuar që kryejnë 70 % të transportit, në kurriz të tyre që janë të licencuar.



PASURIMI I BUKËS ME VITAMINA
Ndonëse OBSH ka kohë që kërkon të luftohet anemia në Shqipëri, e cila ka prekur 30% të popullsisë, ende nuk ka filluar procesi i detyrueshëm i përgatitjes së bukës me vitamina shtesë për të luftuar aneminë. Sipas AKU-së, edhe pse ka nisur të forcohet kontrolli për produktet ushqimore, për këtë çështje mungon një iniciativë ligjore nga ana e ministrisë së shëndetësisë.

Në këtë godinë u strehuan edhe nxënësit e Liceut Artistik

Konvikti i Gjuhëve të Huaja do të mbyllet

Bashkia: Do kthehet në 9-vjeçare, ka pak nxënës

Lajmi

Konviktorët e Liceut Artistik shumë shpejt do të mbeten sërish pa një "çati" mbi kokë. Kjo pasi bashkia e Tiranës ka vendosur që ta mbyllë konviktin e shkollës së mesme të Gjuhëve të Huaja dhe ta kthejë në shkollë 9-vjeçare, me pretendimin në të nuk ka shumë të rinj që qëndrojnë.

■ ■ ■ TIRANE

ESMERALDA KETA

Aktualisht në të janë të strehuar 112 nxënës, të cilët ndjekin shkollën e mesme të Gjuhëve të Huaja "Asim Vokshi" dhe liceun artistik "Jordan Misja" në Tiranë. Ndërkohë që prej shtatorit, në këtë konvikt jetojnë përkohejësisht edhe fëmijët e shtëpisë së jetimëve "Zyber Hallulli", e cila po rikonstruktohet.

Nxënësit e liceut artistik kanë ndërruar "shtëpinë" e tyre vetëm pak ditë më parë, në fillim të muajit janar dhe duket se sërish do të mbeten pa një çati mbi kokë. Kjo pasi bashkia e Tiranës i nxori ata nga konvikti i liceut artistik që është përbërë nga shkollës "Jordan Misja" për ta kthyer në zyrë për administratën.

Por vetëm pak kohë pasi u ka gjetur një strehë të re, bashkia e Tiranës ka një



Më foto: Konvikti i Gjuhëve të Huaja

Projekti

Bashkia e Tiranës për të ulur mbipopullimin e shkollave ka parashikuar edhe shembjen e dy 9-vjeçareve të Tiranës, asaj "Servete Maçi" dhe "Hoxha Tahsim"

tjetër projekt edhe për këtë godinë, por ende nuk ka zgjidhur çështjen se ku do të strehohen këta të rinj pas ndryshimit të destinacionit të këtij konvikti.

Në buxhetin e vitit 2012 për Tiranën, ekspertët e bashkisë e kanë argumentuar këtë vendim me faktin se godina e konviktit të Gjuhëve të Huaja nuk shfrytëzohet sa duhet dhe si rrjedhojë do të jetë më efikasë nëse ajo kthehet në një shkollë 9-vjeçare për njësinë bashkiakë nr.2, njësi në të cilën shkollat janë të mbipopulluara. "Ndërtim

shkollë 9-vjeçare tek konvikti i Gjuhëve të Huaja. Konvikti i gjuhëve të huaja "Asim Vokshi" akomodon nxënës nga i gjithë vendi, por me ngritjen e shkollave, (për të gjithë të huajt nga rrethet e tjera) numri i fëmijëve që jetojnë në

këtë konvikt ka ardhur në ulje të vazhdueshme.

Aktualisht në këtë godinë jetojnë dhe një pjesë e fëmijëve të shtëpisë së fëmijës "Zyber Hallulli". Kjo shkollë ndodhet në njësinë nr.2. Në zonën përreth shkollat e tjera kanë mbipopullim të klasave nga nxënësit dhe ndërtimi i saj do t'i vinte në ndihmë komunitetit. Fondi në dispozicion 67 milionë lekë të reja", - parashikohet në buxhetin e bashkisë së Tiranës në zërin e investimeve të projektuara për njësinë bashkiakë nr.2 të Tiranës.

Drejtori i konvikteve

"Nxënësit nga Saranda e Tropoja"

■ ■ ■ TIRANE



Isa Doçi, Drejtor i Konvikteve të shkollave të mesme, Tiranë

Isa Doçi, drejtor i konvikteve në bashkinë e Tiranës, në një intervistë për "Shqiptarja.com" shpjegon se si funksionon kjo godinë dhe se nxënësit që jetojnë në të janë nga e gjithë Shqipëria, që nga Saranda e deri Tropoja.

Sa nxënës ka konvikti i Gjuhëve të Huaja?

Konvikti ka shumë nxënës, sepse aty janë akomoduar dhe nxënës të Liceut Artistik. Numri i nxënësve gjithsej është 112.

Sa kohë qëndrojnë aty nxënësit?

Aty ka një specifikë. Pjesa e nxënësve të gjuhëve të huaja "Asim Vokshi", normalisht kanë orarin e shkollës paradiete, ndërsa pjesa e nxënësve të Liceut Artistik kanë orarin e shkollës paradiete, por kanë edhe orarin e studimit pasdite që e bëjnë në shkollë.

Sa djem dhe sa vajza ka konvikti?

Më tepër ka vajza sesa djem. Nga 112 nxënës gjithsej, të gjuhëve të huaja janë 34 vajza dhe 16 djem. Te Liceu artistik janë 21 vajza dhe 41 djem.

Po kushtet si janë?

Për kushtet e konvikteve risi, vitin që kaloi ka qënë sistemi i ingrohjes në konvikte. Nëpër dhoma maksimumi i nxënësve është 4, ka edhe dhoma me nga 2 nxënës, por në përgjithësi janë 4. Edhe në pjesën e higjienës tregohet shumë kujdes. Po përipiqemi të rrisim gjithashtu dhe sistemin e sigurisë në konvikte.

INTERVISTOI: ADIONA MEÇA

Vendimi për spitalet

Sa u kushton një pacient

■ ■ ■ TIRANE

Të gjithë spitalet e vendit duhet të llogarisin dhe të dorëzojnë brenda këtij viti pranë Institutit të Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor se sa u kushton çdo pacient. Vendimi është marrë dje në mbledhjen e Këshillit të Ministrave, ku është vendosur që gjithashtu numri i bluzave të bardha të mos ndryshojë, por të mbetet po aq sa ai i një viti më parë, plot 11.800. "Spitalet janë të detyruar të llogarisin shpenzimet faktike të çdo shërbimi, në përputhje me standardet e caktuara nga Ministria e Shëndetësisë. Shpenzimet mujore dhe progresive raportohen nga spitalet në ISKSH, e cila bën monitorimin e tyre", - thuhet në vendimin e Këshillit të Ministrave. Ndërkohë që deri më tani llogaritja e kostove për disa nga shërbimet kryesore ka përfunduar vetëm në disa spitale kryesore të vendit. Kjo bëhet me qëllim që të bëhet një ndarje më e mirë e fondeve të akorduara për çdo spital dhe të shfrytëzimit të kapaciteteve që ata kanë. Ndërkohë që vendimi detajon edhe ndarjen e fondeve për çdo spital, dhe në total ka një rritje të fondit të spitaleve me 2 për qind, pasi në të është përfshirë edhe rritja e pagës që do të përfitojnë bluzat e bardha gjatë vitit 2012. Vendimi i këshillit të ministrave përcakton se ai hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 janar 2012.

Lajmi

Çdo spital duhet të përfundojë deri në fund të vitit 2012, llogaritjen e kostos se sa harxhon për çdo pacient, në varësi të diagnozës që kanë. Vetëm në këtë mënyrë do të mund të bëhet një ndarje më e mirë për buxhetin që do t'i akordohet çdo institucioni shëndetësor në vend.



Investigimi

LAJME
SHKURT

Plaçkitet Galeria Kombëtare greke

Disa hapësira kanë mbetur bosh në muret e Galerisë Kombëtare në Athinë. Kjo, për shkak se nga atje janë vjedhur pikurat e Picasso's dhe, të paktën, edhe të një artisti tjetër.

Vjedhja e veprave të famshme ka ndodhur në mbrëmjen ndërmjet ditës së diele dhe të hënës. Në njoftimin zyrtar të policisë greke thuhet se janë vjedhur edhe dy piktura të artistit Italian, Guglielmo Caccia. Por, mediat greke raportojnë se nga Galeria Kombëtare e Greqisë janë vjedhur piktura "Kokë Gruajë" e vitit 1939, e Picasso's, dhe skica "Mulino" e 1905, e piktorit italian Mondriani. Gjithashtu, njoftohet se alarmi i sigurimit në muze ishte dëgjuar rreth orës 5 të mëngjesit, ndërkohë që mendohet se vjedhja ka ndodhur brenda vetëm shtatë minutave dhe se hajnat kanë hyrë në ndërtesë nga një ballkon anësor. E gjithë ngjarja ka ndodhur në kohën kur po çmontohej një ekspozitë që iu dedikohet "thesareve të panjohura", pjesë e së cilës ishin veprat e Duerer dhe të Rembrandt. Piktura e Picasso's ishte një dhuratë që piktori spanjoll ia kishte dhënë Greqisë, si shenjë nderimi ndaj rezistencës së popullit grek ndaj nazistëve. Nuk dihet ende se sa mund të arrijnë vlerat e pikurave në treg.

Rikthimi i horrorit "Carrie"

Filmi "Carrie", një klasik ky i zhanrit horror i vitit 1976, i regjisorit të njohur Brian De Palma, i bazuar në ekranizimin e vepër të Stephen King, duket se do ribëhet së shpejti. Si rrjedhojë, aktoret e shumta të reja tashmë i kanë hyrë betejës për rolin kryesor. Filmi "Carrie" flet për një vajzë që iu hakmerret shokëve të shkollës gjatë mbrëmjes së maturës, për shkak të talljeve që këta ia kishin bërë paraprakisht. Filmi është bërë në bazë të romanit të mbretit të horrorëve, Stephen King, ndërkohë që rolet kryesore asokohe u shfaqën Sissy Spacek dhe Piper Laurie, të cilat edhe ishin nominuar për çmimin Oscar për rolet e interpretuara në film. Spacek luajti rolin e Carrie, ndërsa Laurie atë të nënës së saj (Margareth) e cila e abuzonte vazhdimisht. Ndryshe, vetë King i tha revistës "Entertainment Weekly" se do të ishte interesante po qe se roli kryesor tani do t'i besohet aktoreve problematike, Lindsey Lohan. Shtypi hollivudian shkruan se përzgjedhja aktuale e regjisorit së versionit t ri, Kimberly Peirce ("Djelmohat nuk Qajnë") është aktoria e re Hailee Steinfeld (15), e cila është nominuar për çmimin Oscar për rolin e saj në filmin "Njeriu i Quajtur Guxim".

SALLAT Një investigim në sallat e ftohta të kryeqytetit. Sa miliona harxhohen për t'i ngrohur, kur është ndërhyrë në sistemet e tyre të ngrohjes, dhe pse spektatorët shohin ende teatër dhe opera me peliçe e xhupa të trashë, të mpirë prej të ftohtit...



TEATRI I AKULLT

150 litra naftë për të ngrohur sallën çdo natë

Në Teatrin Kombëtar harxhohen miliona dhe sërish shfaqjet ndiqen me peliçe e xhupa

NIKO KOTHERJA

Amadeus", një shfaqje gazmore e tragjike në të njëjtën kohë është e vështirë të shijohet deri në fund, këto ditë të ftohta janari në sallën e madhe të Teatrit Kombëtar në Tiranë. Temperaturat në mbrëmje janë pranë zeros. Spektatorët që rëndin drejt teatrit kombëtar, janë të veshur trashë, me xhupa e pallto.

Salla e madhe e Teatrit Kombëtar është ngrohur që më parë. Por vetëm pak minuta ambienti është i ngrohtë. Shpejt të gjithë spektatorët mbështillen mirë poshtë veshjeve të trasha e struken në ndenjëset e kuqe të sallës që sa vjen e ftohet. Deri në fund të shfaqjes, kur aktorët rëndin drejt fillimit të skenës e përkulen para publikut, ky i fundit mezi pret të largohet prej aty, me këmbët e ngrira dhe i mpirë prej të ftohtit.

"Amadeus" rishfaqet sërish nesër në mbrëmje në Teat-



Godina e amortizuar

Godina e Teatrit Kombëtar është ndërtuar në vitin 1936, për të shërbyer për një kohë të shkurtër, jo më shumë se 10 vjet. Ajo u dogj në vitin 1939 dhe është rindërtuar përsëri. Ajo duhej të ishte shembur që në vitin 1946, pasi ishte menduar si e përkohshme, por u la e mbijetoi deri në ditët e sotme. Specialistë të arkitekturës thonë se ajo është e amortizuar dhe për mbajtjen e saj në kushte funksionale duhen shpenzime të mëdha çdo vit dhe kërkohen ndërhyrje të herë pas herëshme.

Nëndrejtori i Teatrit Kombëtar, Besim Kurti

rin Kombëtar. Kjo skenë e përshtuar më lart pritet të realizohet deri në detaje edhe në këtë rikthim të ri të "Amadeusit" për 2012-ën.

Çdo dimër, në këtë teatër, sikurse edhe në Teatrin e Operas dhe Baletit, pak metra më larg, ndodh i njëjti ritual. Spektatorët dhe artistët bëjnë art dhe shijojnë art në

kushte aspak normale.

10 MIJË LITRA KARBURANT ÇDO DIMËR

Kjo sallë teatrore, e kësaj godinë historike, e amortizuar dhe me një sistem ngrohje tejet të vjetruar, harxhon qindra litra karburant për të ngrohur ambientet e sërish salla

është e akullt. Pesë muajt më të vështirë janë: dhjetori, janari, shkurti dhe marsi. Por sa harxhohet çdo vit për të realizuar ngrohjen që sërish nuk është ngrohje në këtë sallë teatrore?

Nëndrejtori i Teatrit Kombëtar, Besim Kurti thotë se salla e madhe e teatrit kombëtar, ka një kaldajë, e cila është vendosur që para 20 vitesh.

"Me kalimin e kohës, kjo kaldajë, sa vjen e rrrënohet më shumë. Ajo nuk arrin ta mbajë

Premiera

Luixhino Hala, solist në trupën e baletit të Selanikut

Një solist shqiptar interpreton sonte me trupën e Selanikut në premierën e rëndësishme "Arrëthyesi". Balerini shqiptar Luixhino Hala, do të jetë ai që do të udhëheqë trupën e baletit grek për më shumë se dy orë, duke realizuar kështu një tjetër ëndërr dhe ambicie në jetën e tij profesionale. Balerini shqiptar, solist i trupës së Universitetit të Arteve në Tiranë, përgatitet prej disa javësh për këtë premierë. Ai shoqërohet edhe nga koreografi i mirënjohur Shpëtim Dajçi, i cili ka ndjekur provat me detaje gjatë qëndrimit të

tij në shtetin Helen. Përgatitjet për këtë premierë kanë nisur prej më se një viti nga trupa e baletit të Selanikut dhe baleti rus do të hapë zyrtarisht sezonin e ri artistik. Luixhino Hala tha para kësaj premiere se emigrantët shqiptarë me të mësuar që në teatër do të "shkelnin" edhe dy shqiptarë, kanë bërë çmos që ata të ishin prezent në premierën e "Arrëthyesi" për të parë bashkëkombasit e tyre. Baleti "Arrëthyesi" është ndër veprat më të njohura dhe është vënë në skenë në më shumë se 60 vende të botës.





Salla e re në TK

Salla e re e teatrit Kombëtar u pajis dy vite më parë me një kaldajë të re. Sot kjo sallë i ka kaluar Teatrit Kombëtar të Komedisë. Ajo është një sallë e ngrohtë, për ngrohjen e së cilës harxhohen 14 litra naftë çdo natë që ka shfaqje. "Kjo për arsye se ambientet e saj janë më vogla, por edhe nëse do i kishte përmasat më të mëdha, nuk do të harxhonte më shumë se 25 litra naftë", thotë nëndrejtori i Teatrit Kombëtar, Besim Kurti.

më. Për këtë arsye ambienti i ngrohur gjatë dy orëve para se të niste shfaqja ftohej shpejt, pothuajse për 15 minuta.

E njëjta gjë ndodh edhe sot në këtë sallë. Nëndrejtori aktual i Teatrit Kombëtar, Besim Kurti shpjegon se sistemi i ngrohjes është me ujë, i cili ngrohet dhe kalon nëpër tuba, të cilët ngrohin radiatorët. Tubacionet janë të gjatë dhe kalojnë në mur dhe nëntokë. Por kontakti që kanë këta tubacione me muret e ftohta e pengon të ngrohtët dhe bën që ajo të humbë rrugës.

"Sipërfaqja është më e madhe dhe kaldaja është e vjetër. Për një shfaqje që është në orën 21:00, ne e lemë ndezur kaldajën deri një orë para. Rreth orës 17:00 e ndezim për të arritur pikun aty nga ora 18:30", shpjegon Kurti, duke theksuar se me këto kushte kjo është e vetmja mënyrë për të ngrohur disi atë ambient.

NJË PROJEKT PËR SISTEM TË RI NGROHJEJE

Në teatrin Kombëtar mësojmë se që para 3 vitesh u hartuan dy projekte për sistem ngrohjeje në Teatrin Kombëtar dhe u dërguan në Ministrinë e Kulturës. Por nga këto dy projekte u miratua fillimisht projekti për sallën e vogël të teatrit e cila sot i ka kaluar Teatrit Kombëtar të Komedisë. U zgjedh fillimisht ajo sallë pasi ishte më emergjente, ajo ishte kreu për ngrohje.

Por ndërsa problemi i ngrohjes për sallën e vogël tashmë është zgjidhur, në Teatrin Kombëtar shpresojnë që këtë vit të ketë një ndërhyrje për sallën e madhe.

Nëse nuk do të bëhet një ndërhyrje e shtrenjtë, sepse ky është një projekt që kushton, atëherë, nëndrejtori Kurti, shpjegon se duhet bërë një ndërhyrje emergjente me një projekt tjetër, që tubacionet të mos jenë direkt jashtë dhe të ndërtohet një korridor duralumini, i cili do të shërbejë edhe për të qëndruar aktorët, edhe për t'u vënë si mbrojtëse për të ftohtët.

Por kjo është thjeshtë një ide, pasi edhe kjo ndërhyrje emergjente mund të mos ndërmerret kurrë. Kjo pasi në planet afatgjatë të qeverisë, prej disa vitesh është zhvendosja e Teatrit nga godina ekzistente, në një godinë tjetër, të re dhe më shumë funksionale.

Nga ideja për ta zhvendosur tek Piramida, e më vonë tek ideja tjetër për ta zhvendosur në ambientet aktuale të Parlamentit, duket se jeta teatrore e kësaj salle do vijojë kështu, me këtë kaldajë të vjetër dhe artdashësit që vijnë në teatër e shohin shfaqje duke u dridhur nga të ftohtët.

Restaurimet

Tre salla të vogla por të ngrohta tek "Metropoli"

Ndryshe nga ambientet e tjera dhe sallat e teatrove, duke i bërë ballë të ftohtës së dimrit. Rikonstruksionet e shumta që ka pasur kjo godinë në vitet e fundit, ka sjellë që artdashësit e kryeqytetit të gjejnë një ambient të ngrohtë. Kjo vjen dhe ngaqë ambientet dhe sallat e "Teatrit të Metropolit" janë prej dërrase. Temperaturat e ulta të stinëve në dimër mesa duket ka ngacmuar rikonstruksionet që sallat e "Metropolit" t'i veshin me dërrasë, e cila e ruan ngrohtësinë. Sipas drejtoreshës së këtij institucioni, Suela Konjari, Qendra Kulturorë "Tirana" ka në dispozicion të saj tre salla teatri, përkatësisht sallën "Shekspir", ku gjenden 270 vende, sallën "Cehov" me 102 vende dhe sallën "Bodrum" me 270 vende. Ngrohja në këto ambiente realizohet me kondicionerë kolonë, të cilët kanë filluar të funksionojnë në vitin 2009. Kjo godinë është ndërtuar rreth vitit 1952 dhe aty u hap estrada e Tiranës. Që prej ndërtimit, godinës i janë bërë dy rikonstruksione para viteve '90 dhe katër të tillë pas viteve '90. Ndërsa çadra e "Cirkut të metropolit" mund të akomodojë 570 njerëz dhe ka sistem ngrohjeje me kaldajë, e cila punon me naftë. Kaldaja e cirkut është vendosur në fund të vitit 2008 dhe harxhon 10 litra për një shfaqje. Shfaqjet janë ditëve të shtuna dhe të diela.

ngrohtët atë ambient", thotë ai, ndërsa shpjegon se për ngrohjen e saj, kaldaja harxhon 40 litra naftë në orë. "Që të arrihet një ngrohje e përshtatshme duhen harxhuar të paktën 150 litra karburant në natë. Kostoja, sidomos me çmimet e sotme të naftës, është mjaft e lartë". Në muajt e ftohtët të vitit Besim Kurti rendit pesë: "Janë muajt dhjetor, janar, shkurt, mars, të cilët janë të ftohtët dhe kanë nevojë që të funksionojë si duhet sistemi i ngrohjes".

Nëse çdo javë shënohen trekatër net me shfaqje në këtë sallë, harxhimi i karburantit për 5 muajt e ftohtët kap shifrën e 10 mijë litrave karburant. Kjo histori vijon që prej 20 viteve.

SI FUNKSIONON KALDAJA

Nëndrejtori Kurti shpjegon se radiatorët janë të vjetër, prej gize.


Projekti

Para dy vitesh teatri Kombëtar aplikoi me një projekt pranë Pro Credit Bank, për të realizuar ngrohje me panele diellore. Projekti nuk u realizua për arsye se financimi ishte shumë i madh dhe kostoja kalonte 300.000 euro.

Ata duhet të ngrohen gjatë gjithë kohës, pasi nëse kaldaja fiket ambientet ftohet shumë shpejt. Ish-drejtori i teatrit kombëtar Xhevdet Ferri ankohej para shumë vitesh për të njëjtin problem. Ai thoshte se në fillim të shfaqjes ishin të detyruar t'i fikin kaldajat pasi shkaktonin zhur-

Parashikimi

Adnan Abrashi: 2012 nuk do të jetë fundi i botës



Adnan Abrashi

21 dhjetori i këtij viti sipas parashikimit të civilizimit Maja, do të sjellë fundin e botës. Por, Adnan Abrashi, humlutes dhe analist i fenomeneve paranormale, në një intervistë për gazetën Express në Kosovë tha se Majat, për kohën e vetë, kanë qenë një popull tepër i zhvilluar dhe shumë i përpunuar në çdo aspekt të dijës.

"Ishin njohës të mirë të matematikës, astronomisë, arkitekturës, e mbi të gjitha, sot më së shumti përmenden si përpilues të një kalendari që sipas kohëzgjatjes parashikuese përfshinë një epokë prej 26 mijë vitesh, e ndarë në pesë etapa të njëjta me nga 5125 vite. Ky kalendari përfshinë periodën e 5-të dhe fillon me parashikime që nga 13 gushti i vitit 3112, përfundimisht deri më 21 dhjetor 2012", u shpreh Abrashi.

Ai shtoi se sikurse toka që rrotullohet rreth boshtit të vetë për 24 orë, rreth diellit për 365 ditë, po ashtu majat kanë llogaritë se i tërë sistemi ynë planetar, për 26 mijë vjet rrotullohet rreth një ylli qendror në univers që quhet Alsioma. Dhe pikërisht data e 21 dhjetorit të vitit 2012, sipas Abrashit, është data kur ky kalendari e përfundon ciklin e vet të 5-të dhe të fundit 26 mijë vjeçar (saktësisht 25,525 vite).

Por Abrashi thotë se aty askund nuk figuron se mbarimi i saj kronologjik, njëkohësisht nënkupton edhe shkatërrimin material të botës. Ai shtoi se ky kalendari në shumë rrethana të gjertanishme, me parashikimet e veta është treguar tejtejt i saktë, por, sipas Abrashit, gabimi më i madh qëndron tek interpretimi shumë i gabuar i këtij kalendari.

"Në fakt, aq është manipuluar me këtë kalendari në opinion, saqë, sot me të nuk merret vetëm

publicistika senzacionaliste botërore, por rreth interpretimit të saj, me të madhe është sfiduar edhe shkenca e jonë reputative oficiale.

E vërteta e saktë është se Majat kanë besua se pas ciklit të fundit të etapës së katër të etapës 26 mijë vjeçare të quajtur si epokë e 'Tokës', ne do të kemi një epokë të re të quajtur si epokë e 'Eterit', e cila, përkundrazi, duhet të interpretohet si epokë e ndryshimeve, transformimit, e paqes dhe harmonisë gjithënjëzore", tha Abrashi. Ai u shpreh se deri më 21 dhjetor vërtetë diçka do të ndodh në botë. "Diçka si shkatërrim, transformim dhe zhdukje, por jo në aspektin fizik-material, sikurse komentohet, por kjo rilindje do të jetë pikërisht në

E vërteta e saktë është se Majat kanë besua se pas ciklit të fundit të etapës së katër të etapës 26 mijë vjeçare të quajtur si etapë e 'Tokës', ne do të kemi një epokë të re të quajtur si epokë e 'Eterit'

shpirtin kolektiv të njerëzimit". Abrashi thekson se sipas këtij kalendari parashikues, viti 2012 mund të jetë një vit i kulmit të rebelimit kolektiv drejt një emancipimi revolucionar shpirtëror të gjithë njerëzimit.

I njohur me shkrimet e tij lidhur me fenomenet paranormale, Abrashi është edhe autor i një libri në të cilin interpreton parashikimet e Nostradamusit. Ai thotë se të gjitha profecitë e shkruara të Nostradamusit si tërësi, me parashikime fillojnë që nga viti 1557 dhe përfundojnë me ngjarjet që do të ndodhin deri në vitin 3797.

Alfred Beka



Ministria e Mbrojtjes, nxjerr në ankand nëntë avionë kinezë



Ministria e Mbrojtjes ka bërë të ditur dje se ka nxjerr në shitje nëntë avionë ushtarak të Forcave të Armatosura Ajrore Shqiptare, të gjithë prodhim kinez. Për shitjen e avionëve do të mbahet një ankand i cili pritet të zhvillohet ditën e hënë dhe do të nis me shifrën fillestare prej 24 milionë lekëve. Avionët

përdoren nga ish-shkolla e aviacionit në Vlorë dhe ish-fusha e aviacionit në Tiranë. Sipas njoftimit të nxjerrë në Agjencinë e Prokurimit Publik, Ministria e Mbrojtjes synon t'i shesë avionët për përdorim jo ushtarak, pasi nuk gjejnë përdorim të mëtejshëm në Forcat e Armatosura. Bëhet fjalë për dy tipe avionesh, Jak

18 prodhim kinez i viti 1971 dhe avion AN-2 prodhim i vitit 1966. Avioni Jak 18, dy vendësh, përdoret në shkollën e aviacionit për njohuritë fillestare të pilotëve të rinj por dhe në aktivitetet të tjera demonstruese, ndërsa avioni AN-2, me kapacitet 10 vendësh, kishte funksione të ndryshme në Forcat e Armatosura.

Prokuroria dorezon dosjen. Mashtronin me naftën "Virxhin"

Karburantet e ushtrisë shqiptare në gjykatë

Shkarkohet zinxhiri komandues i Brigadës Logjistike

Lajmi

Ushtria shqiptare, përveç furnizimit sistematik me naftën jashtë standarteve "Virxhin" nga kompania "Euroil", e cila tashmë është në gjykatë, rezultoi sipas një dokumentacioni fals, se është furnizuar nga Rusia. Gjithashtu ajo është përfshirë edhe nga një skandal i madh abuzimi dhe mashtrimesh me blerjet e karburanteve.

TIRANE

POLI HOXHA

Ka qenë fillimisht një informacion i Shërbimit Informativ të Ushtrisë, shëndëruar më pas në një dosje voluminoze nga Inspektoriati i Kontrollit në Ministrinë e Mbrojtjes, që pasi ka mbërritur në tryezën e ministrit Arben Imami, i ka kaluar direkt njësisë së Task Forcë në Prokurorinë e Rrethit Tiranë, e cila pas një hetimi 4 mujor ka çuar në gjykatë 2 pjesëtarë të forcave të armatosura shqiptare. Ndërkohë mësohet se janë shkarkuar nga detyra kolonel Selim Spahiu, komandant i Brigadës Logjistike dhe nënkolonel Behar Laçi, komandant Batalionit Furnizim-it. Janë larguar nga detyra edhe shefi i Sektorit të Pritjes së Karburantit Arben Zeneli, Ema Kusi dhe Lavdie Qana, sepse nuk kanë kryer analizat laboratorike për cilësinë e karburantit të blerë.

PROCEDIMI

Kryeprokurori i kryeqytetit



Sokol Malaj, thotë për gazetën "Shqipëtarja.com", se njësisia Task Forcë, ka mbyllur hetimin dhe ka dërguar në gjykatë dosjen hetimore në ngarkim disa punonjësve të Brigadës Logjistike në repartin ushtarak të Brarit, për mashtrim, falsifikim dhe abuzim me detyrën". Bëhet fjalë për një tjetër skandal që ka lidhje me karburantet me të cilat është furnizuar për një kohë të gjatë një nga ushtritë e NATO-s. Janë dy punonjësit të kësaj brigade, Dali Koka me detyrë magazinier i karburantit dhe llogaritarja Engjëllushë Demçe, të cilët pas mbylljeve të hetimit janë dërguar si të pandehur në gjykatë me akuzën, "për mashtrim me

sasinë dhe cilësinë e karburantit", të cilin e blinin për llogaritë të furnizimit të mjeteve të ushtrisë shqiptare.

KONTROLI

Sipas kreut të prokurorisë së Tiranës Sokol Malaj, "ka qenë vetë Ministria e Mbrojtjes që ka denoncuar mashtrimin, pas një kontrolli që është zhvilluar në Brigadën e Logjistikës, në Batalionin e Furnizimit". Pas kontrollit që ka pasur si indicie një informacion të shërbimit sekret të ushtrisë, SHIU, është konstatuar se gjatë zbatimit të kontratës, "Furnizim me karburant gazoil D-1 dhe D-2", jo vetëm janë shkëlqer rregullat e pranimit, por janë konstatuar edhe fallsifikime të mëdha. Dy punonjësit të rep-

artit, magazinierit Dali Koka dhe llogaritarës Engjëllushë Demçe, tashmë të akuzuar për shpërdorim detyre dhe falsifikim dokumentesh, ju është vërtetuar se

në fletë-hyrjet dhe fletë-daljet e sasisë së naftës që magazinonin, kanë shënuar shifra fiktive. Prokurorët, pas hetimit disa mujor, kanë zbuluar gjithashtu,

se mashtrimi i dy të akuzuarve ka vazhduar edhe më tej, duke realizuar inventarë fiktivë, me qëllim fshehjen përfundimtare të kërimit financiar të tyre.



REPUBLIKA E SHQIPERISE KONTROLI I LARTE I SHITIT



NJOFTIM PËR VEND TË LIRË PUNE

Kontrolli i Lartë i Shtetit shpall konkursin për vende të lira pune:

1. Për pozicionin e Përgjegjës të Sektorit të Financës dhe Shërbimeve

- Kërkesat për kandidatët e këtij vendi pune janë:
- Të ketë kryer arsimin e lartë të profilit ekonomik.
- Të zotërojë një gjuhë të huaj.
- Të zotërojë programet bazë të kompjuterit.
- Të ketë përvojë pune në profesionin mbi 15 vjet.
- Të ketë aftësi të mira menaxhuese dhe komunikuese.

Paga mujore për këtë vend pune është në nivelin e pagave të shërbimit civil.

Përshkrimi i punës

Ndjek dhe kontrollon zbatimin e legjislacionit të miratuar dhe të detyrave të përcaktuara në dispozitat ligjore dhe nënligjore, për kontabilitetin, menaxhimin financiar dhe përfshirë dhe aktet nënligjore të KLSH. Evident dhe kontrollon shpenzimet buxhetore sipas zërave, nxjerr të dhënat mbi bazën e dokumentave financiare të shpenzimeve, përgjigjet për pasqyrim saktë të evidencës kontabel, në përputhje me planin kontabel dhe ligjin për kontabilitetin; përgjigjet për miratimin dhe pasurisë së institucionit për kryerjen në afat të inventarizimit të vlerave monetare e materiale, bën rakordimin dhe mbylljen mujore të llogarive, kontabilizon veprimet e bankës, arkës në valutë dhe thesarit, kryen rregullisht rakordimet e të dhënave me degën e thesarit dhe Ministrinë e Financave për përdorim e buxhetit, harton projektbuxhetin për vitin e pasardhës, duke përcaktuar nevojat sipas klasifikimit buxhetor. Përgjigjet për furnizimin në sasi, cilësi dhe kohë me mjete materiale, shpërndarjen e tyre sipas kërkesave, normalive dhe planit për institucionin, etj.

Paratija e dokumentave

Kandidati duhet të paraqesë në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore dhe Metodologjisë deri në datë 10/2/2012 këto dokumenta: CV-në, kërkesë për vendin e punës që konkurron, kopje të diplomës së shkollës së lartë dhe të kualifikimeve pasuniversitare, certifikatë e notave dhe librezën e punës të noterizuar, dy rekomandime nga punëdhënësit e mëparshëm, dëshmi penaltit, certifikatë personale, si dhe dokumenta të tjera (nëse ka), që i çmon se mund t'i vlejë për vlerësimin e përgatitjes arsimore dhe profesionale.

Konkurrimi

Konkurrimi është i hapur për nëpunësit civilë nëpërmjet procedurave të pranimit. Konkurrimi do të bazohet në njohuritë për Kushtetutën, ligjin nr.8270, datë 23.12.1997 "Për Kontrollin e Lartë të Shtetit", ndryshuar me ligjin nr.8599, datë 01.06.2000, ligjin nr. 8549, datë 11.11.1999 "Statusi i nëpunësit civil", ligjin nr.9131, datë 8.9.2003 "Për rregullat e etikës në administratën publike", "Rregulloren e brendshme të organizimit dhe funksionimit të KLSH", "Standartet e kontrollit të KLSH" dhe "Standartet ndërkombëtare të INTOSAI", si dhe legjislacionin në fushën e kontabilitetit, menaxhimit financiar dhe kontrollit.

2. Për pozicionin e Kontrollorit në Departament Kontrolli.

- Kërkesat për kandidatët e këtij vendi pune janë:
- Të ketë kryer arsimin e lartë dhe të jetë diplomuar për ekonomist, jurist dhe inxhinier.
- Të ketë njohuri të zgjuara për ekonominë shqiptare, për administratën publike dhe mënyrën e funksionimit të saj.
- Të ketë përvojë pune mbi 10 vjet në organet e sistemit fiskal (tatimor,doganor ose njësi të ngjashme).
- Të njohë mirë dhe të komunikojë me lehtësi në gjuhën angleze, preferohet gjuhë e dytë nga vendet e BE.
- Të zotërojë programet bazë të kompjuterit.
- Të ketë aftësi të mira menaxhuese dhe komunikuese për të punuar në grup.

Paga mujore për këtë vend pune është në nivelin e pagave të shërbimit civil.

Përshkrimi i punës

Ndjek dhe zbaton në mënyrë ligjore profesionale dhe etike, si dhe brenda afateve, detyrat kontrolluese të përcaktuara, konformë standardeve të kontrollit. Gjatë ushtrimit të veprimtarisë kontrolluese harton me cilësi dhe profesionalizëm dokumentacionin e miratuar, përfshirë statistikë e kontrollit, si dhe jep mendime për përmirësimin e punës së kontrollit, drejtorisë apo institucionit.

Paratija e dokumentave

Kandidati duhet të paraqesë në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore dhe Metodologjisë deri në datë 10/2/2012 këto dokumenta: CV-në, kërkesë për vendin e punës që konkurron, kopje të diplomës së shkollës së lartë dhe të kualifikimeve pasuniversitare, certifikatë e notave dhe librezën e punës të noterizuar, dy rekomandime nga punëdhënësit e mëparshëm, dëshmi penaltit, certifikatë personale, si dhe dokumenta të tjera (nëse ka), që i çmon se mund t'i vlejë për vlerësimin e përgatitjes arsimore dhe profesionale.

Konkurrimi

Konkurrimi është i hapur për nëpunësit civilë nëpërmjet procedurave të pranimit. Konkurrimi do të bazohet në njohuritë për Kushtetutën, ligjin nr.8270, datë 23.12.1997 "Për Kontrollin e Lartë të Shtetit", ndryshuar me ligjin nr. 8599, datë 01.06.2000, ligjin nr. 8549, datë 11.11.1999 "Statusi i nëpunësit civil", ligjin nr.9131, datë 8.9.2003 "Për rregullat e etikës në administratën publike", "Rregulloren e brendshme të organizimit dhe funksionimit të KLSH", "Standartet e kontrollit të KLSH" dhe "Standartet ndërkombëtare të INTOSAI", si dhe legjislacionin të sistemit tatimor dhe doganor.

NJOFTIM PËR EKSPERTË TË JASHTËM

Kontrolli i Lartë i Shtetit njofton se kërkon të kontaktojë ekspertë të jashtëm, vendi i punës i të cilëve nuk rregullohet me ligjin nr.85499, datë 11.11.1999 "Statusi i nëpunësit civil", si vijon:

- a) 1 (një) Ekspert të jashtëm për kontrollin dhe vlerësimin e sistemit bankar, i cili duhet të ketë mbi 10 vjet përvojë pune në sektorin e financës dhe kontabilitetit.
- a) 1 (një) Ekspert të jashtëm për kontrollin e njësive ekonomike publike në nivel vendor. I cili duhet të ketë mbi 20 vjet përvojë pune në sektorin e financës dhe kontabilitetit dhe të ketë titullin "Doktor i Shkencave në Ekonomi"
- b) Konkurrimi do të bëhet mbi bazën e dosjeve me dokumentacionin përkatës që vërteton profesionalizmin dhe veprimtarinë e secilit konkurrent.

Ekspertiza e FBI

Shtyhet hetimi për "21 Janarin" edhe 3 muaj

TIRANE

Komisioni Hetimor Par Klamantar për hetimin e një "Grushti shteti", i ngritur me urgjencë vetëm me votat e deputetëve të mazhorancës, mbremjen e 21 Janarit 2011, pas vrasjeve të 4 qytetarëve përpara godinës së Kryeministrit, duke shkelur çdo lig, nuk kanë raportuar asnjëherë për punën e tyre në Kuvend dhe Komisionin e përhershëm të Sigurisë Kombëtare, pranë tij", thotë për

"Shqipëtarja.com", anëtar i këtij komisioni, deputeti Ilir Gjoni. Ndërkohë sipas burimeve pranë Prokurorisë së Përgjithëshme, hetimi për vrasjen e katër demonstruesve, është shtyrë edhe 3 muaj të tjerë. Mësohet se shtyrja e hetimit, është bërë sepse nga laboratorit i FBI, në Shtetet e Bashkuara, ende nuk ka mbërritur dokumentacioni i plotë për ekspertizën e serverit të Kryeministrit, ku besohet se rrureshin ende pamjet filmike të pasdites tragjike të 21 Janarit. Sipas prokurorëve të çështjes,

ka mbërritur vetëm konfirmimi, se ato janë fshehur deri në orën 24.00 të asaj nate. Gjithashtu nga organi i akuzës, bëhet e ditur se, gjatë shqyrtimit të dosjes nuk është gjetur asnjë element për veprën penale të grushtit të shtetit, por vetëm element të tejkalimit të rregullave të miteingjeve dhe dhunës. Demonstruesit e akuzuar për këtë veprë penale tashmë janë proceduar ndërsa pritet të përfundojë dosja e hetimit për efektivet e Gardës që qëlluan drejt turmës së demonstruesve.



ZBAVITJE

SHQIPTARJA *editë e re*

Birrë kundër gurëve në veshka

Jo gjithmonë pijet alkooolike shkaktojnë vetëm dëme në organizmin e njeriut. Birra, për shembull, mund të shërbejë edhe si një masë parandaluese për sëmundjet që prekin veshkat. Të paktën në një konkluzion të tillë kanë arritur disa shkencëtarë holandezë në një studim të tyre të kohëve të fundit. Kështu, studuesit në fjalë, pas një testimi të kryer në një kampion prej 27 mijë njerëzish që konsumonin vazhdimisht birrë arritën në përfundimin se pija shkumbëzuese mund të përbëjë një element parandalues kundër formimit të gurëve në veshka. Nga studimi i mësipërm rezultoi se te njerëzit që pinë çdo ditë birrë mundësia e formimit të gurëve në veshka është 40 përqind më e ulët se te njerëzit që nuk konsumojnë birrë.



Gromësin? Dorëzo patentën!

Më në fund, pas një ndjekjeje relativisht të gjatë, policia e New Hampshire mundi të ndalojë makinën e drejtuar nga James Jordan, që ecte me shpejtësi shumë më të madhe nga norma e lejuar. Dhe. Siç ndodh zakonisht në raste të tilla, e çuan në stacionin më të afërt të policisë dhe dëshën të kontrollonin nivelin askoolit. Mirëpo pikërisht në momentin e provës, Jordan, që deri atëherë nuk ishte ndërjerë fare, filloi të gromësinë pa pushim. Duke qenë se gromësimat janë të tilla që mund të ndryshojnë rezultatit e testit të nivelit askoolit, policia e detyroi të mos gromësinë për 20 minuta, por ajo vetëm që vazhdoi, por herëpashere i këputte edhe ndonjë të vjellë. Atëherë, duke parë se nuk ishte e mundur t'i bëhej testi, policia i ra fare shkurt. I hoqi patentën...



Të paguash për qenin

Gjatë procesit gjyqësor për t'u ndarë përfundimisht nga i shoqi, amerikania Deborah Anderson, në bazë të provave që paraqiti, nuk e pati shumë të vështirë për të fituar divorcin. Por vështirësinë më të madhe e pati për të marrë nën kujdesin e saj Janie, qenin e vogël të familjes. Vetëm për shkak të këmbënguljes së madhe të saj, kuptohet edhe me argumentet e paraqitura, zozja Anderson arriti t'i bindë gjyqtarët për t'ia besuar asaj rritjen e qenit. Dhe kështu, ata jo vetëm që ia lanë asaj në ngarkim, por e detyruan burrin që të derdhte çdo muaj 150 dollarë për llogaritë të ish gruas e që do të ishin për shpenzimet e qenit. Ishte vërtet një rast i pazakontë, pasi qeni nga ana juridike u trajtua si të ishte një fëmijë.



SUPER FJALEKRYQ

	1	2	3	4	5	6	7	8		9		10	11	12	13	14		15		16	17	18	19	20
21																								
29	30																							
35					36																			
42																								
46																								
52																								
58																								
79																								
86																								

HORIZONTAL

1. Ai i 38 ndan dy Koretë.
9. U bindeshin feudalëve.
16. Eshhtë sulmi me mig.
22. U shkrua nga Jules Verne.
24. Teket e një bombe.
26. Ariti japonez i zbulimit me letra.
28. Eshhtë figurë gjeometrike.
29. Janë ekipe.
31. Rruajtje pa ujë.
32. Ndërmarrje Industriale Tiranë.
33. U quajt edhe Toka e van Diemen.
35. Qorre pa e.
36. Inicialet e Delon.
37. Janë hebrejtë e Spanjës.
40. Janë metrat për gjatësi.
42. Simon i Duran Duran.
43. Eshhtë karta e dokumentit personal.
44. Eshhtë metoda hebraike e interpretimit të Biblës.
46. Mund të jetë kuzhine.
47. I largët ai me cowboy-s.
49. Rryma e Andy Warhol.
50. Qerre pa qe.
52. Thomas i Tonio Kröger.
53. Kështu pretendohet të ishte raca ariane.
54. Një metër në kufij.
56. Ao të zjarrit janë për ngrohje.
57. Një element me simbol Cl.
58. Eshhtë djaloshi.
59. Portokalli i Stanlei Kubrick.
60. Janë në jetë.
61. Mirë në qendër.
62. Marubi i fotografisë.

63. Janë pjesë telefilm.
65. Grup pop italian.
67. Eshhtë e pastër ajo ariane.
68. Një profet i vogël.
70. Një yankee.
71. Janë koka...në Tiranë.
73. Në krye të subjekteve.
75. Ishin bij të të shtatëve kundër Tebës.
78. Pak emocionuese.
79. Antonio, që qe kompozitor italian.
80. Janë alpet e Ballkanit.
82. Mbyllin një simbol.
83. Janë spiunët.
86. Pret pa re.
87. Ridley e Alien.

88. Kufijtë e drejtëzës.
 89. Si moral.
 90. Eshhtë fëmija i gjirit.
- VERTIKAL**
2. Qe mbret i Asirëve.
 3. Me to bëjnë torta.
 4. Fanny aktore.
 5. Ishte titulli i Byron.
 6. Ente Grumbullimi Autonome.
 7. Flota pa kufij.
 8. Inicialet e Fleming që krijoi James Bond.
 9. Duhet marrë kolegjalisht.
 10. Këtë mbërmje.

11. Këdohen në opera.
12. Pak literaturë.
13. Janë në degë.
14. Janë Organet e taksave.
15. Mund të jenë kokë më kokë.
16. Mali ku ngeci Arka.
17. Tommy Lee aktori.
18. Armik pa kufij.
19. Organizma Botuese Autonome.
20. Fund janari.
21. Një këngë e famshem italiane.
23. Dard që krijoi komisarin San Antonio.
24. Marlon që qe aktor.

25. Janë dëshmorë të kishës.
27. Ishin njësi kohortash.
30. Kush është... nuk e ul kokën.
34. Eshhtë radio... për të dëgjuar.
37. I dëgjoji vetëm Odiseu.
38. Jetonin në brigjet e Kanaanit.
39. Fitim pa kufij.
41. Janë rryma.
45. Ishte mali i muzave.
47. Kodi i dytë i celularit.
48. Ishte Fjala.
49. Partia Demokratiane.
51. Nino kompozitor.
53. Kush bën... vështron.
54. Luca aktore.
55. Eshhtë paga.
57. Janë të dënueshme.
59. Ka shtretër për hotel një i tillë.
64. Nuk pranohet kollaj nga konservatorët.
66. Një pjesë e opinionit.
68. Hapin pa kufij.
69. Të parat në sondazh.
71. Një i fundit mbi të gjithë.
72. Fillon ndryshe.
74. Mbyllin krahu.
75. Tersi, por jo ti.
76. Kush nuk di... mbytet.
77. Wallach aktori.
79. Inicialet Penn aktori.
80. Duhet në ekstreme.
81. Inicialet e Daudet.
84. Në krye të gladiatorëve.
85. Takohen në kufij.

PERGJIGJET E NUMRIT TE DJESHEM

P	A	R	L	A	M	E	N	T	A	R		S		K	A	K	A		D	A	T	E				
E	K	U	A	T	O	R	I		W	S		S	T	P	A	R	G	O	N	A	U	T	E			
R	A	S	T	I	S	U	R		M	E	H	U	E	A	L	I	A	M	N	E	S	O	N			
E	D	I	L	T	O		P	O	R	T	O	K	A	L	L	I	R	E	E	D		H	R	A		
N	E	A	A	E	R		K	U	N	D	E	R	S	U	L	M	E	T		D	T	E		E		
D	M		L	A	R		B	U	S	T	E	R	K	E	A	T	O	N	A	I	T		D	E	M	A
E	I	N	E		M	E	S	H	I	R	U	E	S		O	A	P		E	M	I	R	A	T		
S	K	E	H	A	J	D	U	K		A	S	I	S	T	E	N	C	A		O	R	O	L			
H	E	I	E	R	A	E	R	E		A	R	T		I	L	O	I	R	A		T	E	S	T	E	
A	T	L	A	S		F	L	E	T	E	T		R	O	T	T	E	R	D	A	M		O	K	A	T
T		F	A	K	T	E	T		K	O	A	G	A	I		M	E	T	E	O	R	E	T	E		
R	R	I	P	I		T		T	O	M		T	A	R	I	F	A	T		N	D		T	A	K	T

HOROSKOPI

- Dashi** Mbështjete që keni nga shumë vje sot duhet të jetë një stimul i mirë për të gjithë që i përkasin kësaj shenje, ndonëse jo gjithëcka duhet ta prisni nga qel-li. Sa skeptikë ndaj partnerit tuaj.
- Demi** Edhe pse mund të jeni në momentin më të përshtatshëm për të vazhduar në një drejtim të caktuar punë, sot vjet, më konkretisht Afërda, do t'ju orientojë në një drejtim tjetër. Në atë atë të dashurisë.
- Binjaket** Është një periudhë shumë pozitive që po kaloni në aspektin e punës, e cila duket se do të vazhdojë për një kohë të gjatë, opasi edhe mbështjete e yjeve, sidomos e Merkurit do të jetë e tillë.
- Caforja** Sot suhet të bëni shumë kujdes në raportet ndërpersonale, pasi keni prirjen për t'u kapur me të gjithë edhe për gjërath më të vogla. Ndoshta dikujt pa dëshje i keni shkelur në kallo.
- Luan** Do të jeni të mbështetur nga Marsi, Merkuri dhe Afërda, prandaj nuk duhet ta frenoni veten për iniciativa në të gjitha fushat e jetës. Mund të jeni ju pikërisht ju ai ku kërkon të mbështet një epror.
- Virgjëresha** Janë pikërisht kontrastet e planetëve në shenjën tuaj që bëjnë të jeni edhe ju kontradiktore me të tjerët, enë raste të caktuara edhe me veten tuaj. Më shumë duhet të bëni për raportet me partnerin.
- Peshorja** Një situata yjore e ekuilibruar, ku një mori planetesh në shenjën tuaj ju favorizojnë, duke kundërshtuar kësaj edhe ndikimin negativ të Saturnit. A nuk keni përshtypjen se jeta juaj sentimentale është vakët?
- Akrepi** Duket se sot mund të kurojëzohen përpjekjet tuaja për të arritur atë që dëshironi. Përse kërkoni të bëni gjithëcka vetë kur keni të tjerë rreth vetes që muna të japin kontributin e tyre?
- Shigjetari** Urani sot është planeti juaj, i cili do të "kontribujë" ju pak që ta keni më të lehtë për të arritur synimet tuaja. Por kujdes, sepse keni prirje të lini gjërath përgjigjme e kjo ju dëmon të tepërm.
- Bricjapi** Përvishni mëngët e futuri punës, sepse është Merkuri që sot favorizon në mënyrë të veçantë në këtë drejtim. Një investim i dikurshëm duket se po fillon tani të japë rezultatet e para pozitive.
- Ujori** Në planin sentimental duket se do të jenë shumë të favorizuar në këtë periudhë dhe ky është momenti i duhur për të shfrytëzuar të gjitha mundësitë që ju paraqiten. Kujdes, ekonomia në rënje.
- Peshqit** Përgatituni për një ditë relativisht të vështirë sepse sot ju vetëm që nuk do të keni mbështetjen e yjeve, por, janë edhe ata që ju rrethojnë sot nuk i keni për asgjë, në mos për t'iu prishur punë.

**LAJMET
NGA BOTA**

• Gjermani, i pandehuri vret prokurorin
Një prokuror gjerman u vra në sallën e gjyqit nga një i pandehur, i cili hapi zjarr në drejtim të tij dhe të gjykatësit së çështjes, raportuan dje mediat gjermane. Ngjarja ndodhi në Gjykatën Administrative të Dakaut, në Bavari, pasditen e së mërkurës. Pasi qëlloi fillimisht ndaj gjykatësit, i pandehuri 54-vjeçar shënjestroi prokurorin, të cilin plumbat e goditën në krah, stomak dhe shpatull. 31-vjeçari, i punësuar në detyrën e tij prej vetëm një viti, ndërroi jetë në spital. Rojet e sigurisë ndërhyjnë me vonesë dhe mundën të kontrollonin agresorin.

• Iran, vritet shkencëtari nuklear
Një profesor universiteti dhe një shkencëtar nuklear u vranë mëngjezin e djeshëm pas shpërthimit të një bombe të vendosur në një makinë në Teheran. Sipas autoriteteve iraniane dhe medieve vendase, bëhet fjalë për profesor Mostafa Ahmadi Roshan, një akademik i cili ka punuar gjatë në Iran. Shpërthimi ndodhi në momentin që një motoçiklist vendosi në një makinë një bombë manjetike. Shumë shkencëtarë nuklearë në Iran janë vrarë në vitet e fundit dhe për këtë Irani akuzon Izraelin dhe SHBA.

• SHBA, Mitt Romney shpall fitoren në New Hampshire
Ish guvernatori i Massachusetts Mitt Romney ka shpallur fitoren në zgjedhjet paraprake republikane në shtetin New Hampshire në procesin e zgjedhjes së kandidatit republikan për zgjedhjet presidenciale të nëntorit. Kur janë numëruar më shumë se gjysma e votave zoti Romney kryeson me avantazh të lartë përballë kongresmenit nga Teksasi Ron Paul. Ish ambasadori amerikan në Kinë, Jon Huntsman, ndodhet në vendin e tretë, ndërkohë që ish kryetari i Dhomës së Përfaqësuesve Neët Gingrich dhe ish senatori amerikan Rick Santorum luftojnë për vendin e katërt.

• Kriza e BE, Merkel merr fjalën e Montit
Në vijim të takimeve me liderët e vendeve të BE-së për shpëtimin e Eurozonës nga kriza financiare, kancelarja gjermane Angela Merkel mori mbështetjen e Italisë për taksën e re mbi transakcionet financiare e rrijohur si taksa Tobin, e cila kundërshtohet nga kryeministri britanik David Kameron. Këtë mbështetje e dha sot në Berlin, kryeministri italian Mario Monti, i cili në ndryshim nga çfarë kishte mbrojtur më parë, theksoi se në kushtet e krizës financiare kjo taksë është e nevojshme për Unionin Europian.

• Kosovë, mund të shtyhen zgjedhjet presidenciale
Kryetari i Kuvendit, Jakup Krasniqi përmend për herë të parë mundësinë e shtyrjes së zgjedhjeve presidenciale. Lajmi bëhet i ditur nga gazeta Koha Ditore. Kryesia e Kuvendit ka diskutuar gjatë për kërkesën e Komisionit për amendamentimin e Kushtetutës për t'i dhënë një mandat të ri për ndryshimin e nenit 84 lidhur me kompetencat e presidentit. Për këtë çështje do të vendoset më 20 janar në seancën e Kuvendit. Mirëpo, kryeparlamentari Krasniqi ka deklaruar që nëse ndryshohet neni 84, duhet të ndryshohet edhe nenet kushtetuese 64 e 65, që flasin për zgjedhjen e presidentit nga ana e Kuvendit.




ADRIATICA
t r a g h e t t i



**UDHËTONI ME
"ADRIATICA Traghetti"**



**KUALITET
KOMODITET
SIGURI**



Cdo dite, gjithë vitin nga Bari për ne Durres dhe anasjelltas
Kuzhina me e mire në linjen Bari Durres • Restorant për 400 persona të ulur rehatshëm dhe komoditet • E vetmja anije me kabina me krevat dopjo dhe suita për VIP
Salle "casino" në bord Sherbim BAR me muzikë • Në bord flitet gjuha shqipe • Salle VIP
www.adriaticatraghetti.com

• Alba Malltezi
Drejtoreshë e Përgjithshme
e Free and Fair Media Group
• Anila Basha
Drejtoreshë e Shqiptarja.com

Kryeredaktor: Arben Rrozhani
Politika: Jakin Marena
Ekonomia: Genc Kondi
Investigimi: Poli Hoxha
Sociale: Esmeralda Keta
Kultura: Admirina Peçi

Design: Altin Aliaj
Genti Manelli
Website: Suela Gera
Antuen Hoxha

Julia DHAME
Drejtoreshë Marketingu:
Cel: +355696060419
julia.dhame@shqiptarja.com
Shpërndarja:
Saimir ZENELAJ
Cel: +355696060418

Redaksia: Rruga:
"Dervish Hima" tre kullat,
kulla e dytë - Tiranë. e-mail:
redaksia@shqiptarja.com
Shtypur në shtypshkronjën:
A.K shpk, rruga 5 maji, Tiranë